



DIALOGU KOSOVË-SERBI NË LEGJISLATURËN E PESTË TË KUVENDIT TË KOSOVËS


2014-2017



MARS 2018

DIALOGU KOSOVË-SERBI NË LEGJISLATURËN E PESTË TË KUVENDIT TË KOSOVËS

2014-2017



MARS 2018

COPYRIGHT © 2018. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo-komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

RAPORTI I PËRGATITUR NGA: Jeta Krasniqi, Artan Murati dhe Violeta Haxholli

DESIGN & LAYOUT: envinion

Vërejtje: Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi", i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

LISTA E TABELAVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
1. HYRJE	10
2. DIALOGU NË SEANCAT E KUVENDIT	11
3. MBIKQYRJA PARLAMENTARE E DIALOGUT KOSOVË – SERBI	18
3.1. Interpelancat.....	18
3.2 Pyetjet Parlamentare rreth Dialogut.....	20
3.3 Pyetjet e qytarëve për deputetët te votaime.org seksioni ‘Pyet deputetit?’ lidhur me procesin e dialogut.....	22
3.4 Propozim Rezolutat dhe Rezolutat rreth Dialogut.....	22
3.4.1 Rezoluta Nr. 05-R-02 lidhur me ndalimin e deputetit Ramush Haradinaj në Slloveni	22
3.4.2 Rezoluta Nr. 05-R-05, lidhur me arrestimin e zotit Nehat Taçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës, nga autoritetet e Serbisë	22
3.4.3 Rezoluta Nr. 05-R-007, lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën Veriore të Mitrovicës	23
3.4.4 Rezoluta Nr. 05-R-011, lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë	23
4. DIALOGU NË KOMISIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS ...	24
4.1 Komisioni për Buxhet dhe Financa.....	24
4.2 Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim	26
4.3 Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit.....	28
4.4 Komisioni për Integritet Evropian.....	29
4.5 Komisioni për Punë të Jashtme.....	31
4.6 Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	33
4.7 Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.....	34
4.8 Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri	34
4.9 Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	36
4.10 Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor	37
4.11 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbiqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.....	38
4.12 Komisioni për Mbiqyrjen e Agjencionit Kosovar për Intelejgencë	39
4.13 Komisioni për Mbiqyrjen e Financave Publike	39
4.14 Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	39
4.15 Komisioni Parlamentar për Stabilizim Asociim.....	40
4.16 Takimi Koordinues i Komisioneve Parlamentare Rreth Dialogut Kosove-Serbi.....	41
5. REKOMANDIME	43



LISTA E TABELAVE

- TABELA 1** Dialogu në Seancat e Legjislaturës së pestë
- TABELA 2** Pasqyrë e pyetjeve parlamentare rreth temave të dialogut gjatë legjislaturës së pestë
- TABELA 3** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Buxhet dhe Financa
- TABELA 4** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
- TABELA 5** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrje të AKK-së
- TABELA 6** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Integritet Evropian
- TABELA 7** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Punë të Jashtme
- TABELA 8** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport
- TABELA 9** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media
- TABELA 10** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri
- TABELA 11** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
- TABELA 12** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor
- TABELA 13** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së
- TABELA 14** Diskutimet rreth dialogut në Komisionin për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione





Marrëveshjet që do të nënshkruhen në Bruksel mes Kosovës dhe Serbisë t'i prezantohen paraprakisht Kuvendit për diskutim dhe jo pas nënshkrimit të tyre.



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Legjislatura e pestë e Kuvendit të Republikës së Kosovës filloi punën me seancën konstituive më 8 dhjetor 2014 pas 6 muajsh përpjekjesh për formimin e qeverisë, në krye të të cilës erdhi kryetari i LDK-së z. Isa Mustafa.

Kjo legjislaturë do të trajtonte çështje si demarkimi i kufirit në mes Kosovës dhe Malit të Zi dhe Marrëveshja për Asociacionin e komunave me shumicë serbe pjesë e Marrëveshjeve së Brukselit dhe e paketës së marrëveshjeve të arritura në mes Kryeministrit të Kosovës z. Mustafa dhe Kryeministrit të Serbisë z. Vuçiç më 25 gusht 2015. Këto çështje të interesit të lartë shtetëror polarizuan skenën politike në vend, nxitën protesta të qytetarëve dhe panë përdorimin e gazit lotsjellës nga partitë opozitare në Kuvendin e Kosovës duke bllokuar dhe funksionimin e rregullt të këtij institucioni.

Në vitin 2010, OKB do të kalonte Rezolutën me anë të së cilës u paralajmërua një dialog në mes Kosovës dhe Serbisë për të përmirësuar jetën e qytetarëve, për të zgjidhur çështjet e pazgjidhura në mes palëve, për të promovuar paqen dhe stabilitetin në ndërmjetësimin e BE-së.

Kuvendi i Kosovës me 2011 do të kalonte Rezolutën me anë të së cilës filloi dialogu teknik dhe më 2012 Rezolutën për dialogun e normalizimit apo siç thuhet rëndom, dialogun politik. Me anë të këtyre Rezolutave, Kuvendi i Kosovës do të jepte aprovimin e tij për një proces dialogu në mes shtetit të Kosovës dhe të Serbisë duke mandatuar Qeverinë si udhëheqëse të këtyre bisedimeve dhe negociatorët e nominuar prej saj. Gjithashtu me anë të këtyre Rezolutave Kuvendi i Kosovës do të kërkonte Qeverisë platformën shtetërore në këto bisedime, do ta obligonte Qeverinë të raportonte rregullisht në Kuvend dhe Komisionin për Punë të Jashtme (pa përjashtuar komisionet e tjera) mbi bisedimet e zhvilluara, dhe në raste të caktuara edhe komisionet parlamentare u kërkuan që të ishin pjesë e këtyre bisedimeve në bazë të fushëveprimit të tyre.

Mungesa e transparencës së procesit të dialogut, dhe mungesa e llogaridhënies ndaj Kuvendit e bën këtë proces të dialogut të largët për deputetët e Kuvendit dhe për qytetarët, ndërsa kundërthëniet e shumta rreth marrëveshjeve të arritura polarizuan skenën politike në vend.

Duke konsideruar rolin e rëndësishëm që Kuvendi i Kosovës duhet të ketë në kuadër të procesit të dialogut Kosovë-Serbi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) i ofron asistencë Kuvendit në fuqizimin e rolit të tij në kuadër të këtij procesi si dhe monitoron nga afër punën e këtij institucioni rreth kësaj çështjeje.

KDI në gusht 2015 ka nënshkruar me Kuvendin e Kosovës një Memorandumit të Bashkëpunimit për të fuqizuar mbikëqyrjen parlamentare të ekzekutivit dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi. Në kuadër të këtij Memorandumi, KDI u ka ofruar asistencë të vazhdueshme deputetëve të Kuvendit, Komisioneve Parlamentare duke synuar transparencë, vendimarrje të informuar, pjesëmarrje qytetare dhe llogaridhënie.

Gjatë procesit të monitorimit KDI ka gjetur se Kuvendi i Kosovës gjatë legjislaturës së pestë, çështjet që ndërlidhen me procesin e dialogut Kosovë-Serbi i ka diskutuar në 62% të seancave të përgjithshme, ndërsa në 24% të seancave të mbajtura çështja e dialogut ishte pjesë e rendit të ditës.

Temat më të diskutuara të ndërlidhura me këtë proces kanë qenë Marrëveshja e Parë e Parimeve për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, strukturat paralele serbe, personat e pagjetur dhe marrëveshja për drejtësinë. Po ashtu, janë mbajtur edhe tri (3) interpelanca me temë çështjen e dialogut ku është diskutuar rreth kodit telefonik të Kosovës, strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës dhe ndikimin e drejtpërdrejtë të Qeverisë së Serbisë në deputetët e Kuvendit dhe anëtarët e Qeverisë nga radhët e Listës serbe (Shih në seksionin e interpelancave).

Gjatë seancave të mbajtura deputetët e Kuvendit parashtruan 28 pyetje parlamentare lidhur me këtë temë nga gjithsej 428 pyetje parlamentare të parashtruara gjatë kësaj legjislaturore. Qeveria e Kosovës u përgjigj në gjysmën (14) nga pyetjet rreth dialogut.

Në anën tjetër edhe qytetarët e vendit kanë shfrytëzuar mundësinë për t'iu shtruar pyetje deputetëve të Kuvendit përmes platformës së KDI-së Vota Ime. Ata gjatë legjislaturës së pestë parashtruan gjithsej 82 pyetje për deputetët, nga të cilat 12 ishin të ndërlidhura me procesin dhe temat e dialogut Kosovë-Serbi, ku vetëm tre prej tyre gjetën përgjigje.





Gjatë legjislaturës së pestë të Kuvendit të Kosovës deputetët kanë iniciuar 7 propozim Rezoluta rreth dialogut Kosovë- Serbi, nga të cilat 4 propozim Rezoluta janë miratuar. Ndër to, Kuvendi miratoi për herë të parë edhe një rezolutë me anë të së cilës kërkoi pezullimin e dialogut Kosovë-Serbi kjo pas ndalimit në Francë të Kryeministrit aktual të Kosovës z. Ramush Haradinaj dhe tensionimin e situatës në mes palëve.

Përveç diskutimit të temës së dialogut në seancat e Kuvendit, kjo temë u diskutua edhe në Komisionet e Kuvendit. Procesi i dialogut Kosovë-Serbi si dhe marrëveshjet e arritura në kuadër të këtij procesi janë trajtuar në 115 mbledhje të Komisioneve parlamentare nga gjithsej 1005 mbledhje të mbajtura. Shikuar në përqindje, çështjet lidhur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi janë diskutuar në 11% të mbledhjeve të Komisioneve të Kuvendit, ndërsa në vetëm 3% të tyre, këto çështje kanë qenë pjesë e rendit të ditës.

Komisionet parlamentare të cilat kanë trajtuar më së shumti temën e dialogut Kosovë - Serbi gjatë legjislaturës së pestë kanë qenë, Komisioni për Integritim Evropian, Komisioni për Punë të Jashtme, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si dhe Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Komisionet parlamentare në ushtrimin e rolit mbikëqyrës ndaj ekzekutivit në raportime dhe dëgjime publike kanë ftuar Ministrat e Qeverisë në 180 mbledhje. Çështjet që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi janë ngritur në 34 prej këtyre mbledhjeve, ndërsa në vetëm 11 mbledhje ministrat e Qeverisë së Kosovës janë ftuar të raportojnë ekskluzivisht për dialogun Kosovë-Serbi. Shikuar në përqindje, Ministrat e qeverisë kanë raportuar ekskluzivisht për dialogun në 6% të mbledhjeve të Komisioneve, ndërsa në 19% të mbledhjeve ku ata kanë qenë të ftuar janë ngritur çështjet e ndërlidhura me dialogun Kosovë-Serbi.

Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme me përkrahjen e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) gjatë legjislaturës së pestë ka mbajtur takimin e parë koordinues të Komisioneve Parlamentare të Kuvendit rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi. Ky takim u organizua në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar në mes Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe Kuvendit të Kosovës më 6 korrik 2016 lidhur me fuqizimin e mbikëqyrjes së

Kuvendit ndaj Qeverisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi.

Gjatë kësaj periudhe KDI ka organizuar vizita të deputetëve në terren për të monitoruar nga afër zbatimin e marrëveshjeve, takime të deputetëve me qytetar në tërë rajonet e Kosovës, diskutime nacionale në mes përfaqësuesve institucional dhe shoqërisë civile për të promovuar transparencë, dhe pjesëmarrje në kuadër të procesit të dialogut Kosovë-Serbi.



Komisionet parlamentare të cilat kanë trajtuar më së shumti temën e dialogut Kosovë - Serbi gjatë legjislaturës së pestë kanë qenë, Komisioni për Integritim Evropian, Komisioni për Punë të Jashtme, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si dhe Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.





1. HYRJJE

Ky raport nxjerr në pah punën e Kuvendit të Kosovës në trajtimin e rolit të saj mbikëqyrës dhe monitorues ndaj ekzekutivit të vendit rreth procesit të dialogut Kosovë—Serbi gjatë legjislaturës së pestë, e cila u konstituua më 8 dhjetor 2014 dhe u shpërnda më 10 maj 2017.

Në pjesën e parë të raportit trajtohet mbikëqyrja parlamentare e dialogut Kosovë-Serbi ku ofrohen informacione mbi seancat pleanare në të cilat është diskutuar rreth çështjeve që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi, përfshirë interpelancat rreth dialogut, pyetjet parlamentare të ngritura nga deputetët e Kuvendit si dhe pyetjet e qytetarëve për deputetët e Kuvendit të Kosovës me anë të platformës së KDI-së votaime.org - 'Pyet Deputetin?'.

Në pjesën e dytë raporti sjell Rezolutat të cilat janë inicuar gjatë legjislaturës së pestë lidhur me procesin e dialogut duke ofruar informacione rreth diskutimeve të bëra, propozuesve dhe qëllimit të Rezolutave dhe efekteve të tyre në procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

Në pjesën e tretë raporti trajton mbikëqyrjen e ushtruar nga ana e Komisioneve parlamentare ndaj ekzekutivit rreth marrëveshjeve që dalin nga dialogu Kosovë-Serbi. Kjo pjesë ofron një përmbledhje të përgjithshme të të gjitha komisioneve parlamentare si dhe informacione mbi secilin komision parlamentar të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Puna e Komisioneve parlamentare është shpërfaqur duke hulumtuar sa herë çështje që ndërlidhen me procesin e dialogut janë diskutuar në takimet e komisioneve, sa herë ato kanë qenë pjesë e rendit të ditës dhe sa herë ministrat kanë raportuar në komisione rreth çështjeve që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi.

Në kuadër të bashkëpunimit që Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka filluar me Kuvendin e Kosovës pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në gusht 2016, Komisioni për Punë të Jashtme ka inicuar takimet koordinuese në mes komisioneve parlamentare me qëllim bashkërendimin, koordinimin, rritjen e mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit dhe rritjen e transparencës rreth procesit të dialogut. Rreth këtij takimi ofrohen informacione në pjesën e katërt të raportit.

Ndërsa në përfundim të këtij raporti ofrohen rekomandime rreth rolit të Kuvendit në procesin e dialogut Kosovë-Serbi, në rritjen e transparencës, bashkërendimin institucional dhe llogaridhënies.



Ky raport nxjerr në pah punën e Kuvendit të Kosovës në trajtimin e rolit të saj mbikëqyrës dhe monitorues ndaj ekzekutivit të vendit rreth procesit të dialogut Kosovë—Serbi gjatë legjislaturës së pestë, e cila u konstituua më 8 dhjetor 2014 dhe u shpërnda më 10 maj 2017.





2. DIALOGU NË SEANCAT E KUVENDIT

Në legjislaturën e pestë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila ka filluar punën me seancën konstituive më 8 dhjetor 2014, deri tek shpërndarja me 10 maj 2017, janë mbajtur gjithsej 103 seanca. Kuvendi i Kosovës gjatë kësaj legjislature çështjet që ndërlihen me procesin e dialogut Kosovë-Serbi i ka diskutuar në 63 seanca. Temat më të diskutuara gjatë seancave të Kuvendit të ndërlihdura me këtë proces kanë qenë Marrëveshja e Parë e Parimeve për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, strukturat paralele serbe, personat e pagjetur dhe marrëveshja për drejtësinë.

Ndërsa, çështje që ndërlihen me dialogun Kosovë-Serbi kanë qenë pjesë e rendit të ditës në 25 raste në 23 seanca të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Shih Tabelën 1). Janë thirrur gjithsej 12 interpelanca¹, tri (3) nga të cilat kanë pasur për temë çështjen e dialogut Kosovë - Serbi.

Në përgjithësi, çështjet lidhur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi janë diskutuar në 62% të seancave të Kuvendit përgjatë kësaj legjislature, ndërsa në 24% të tyre këto çështje kanë qenë të parapara edhe me rendin e ditës.

Në përgjithësi, çështjet lidhur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi janë diskutuar në

62%

të seancave të Kuvendit përgjatë kësaj legjislature, ndërsa në

24%

të tyre këto çështje kanë qenë të parapara edhe me rendin e ditës.

¹ Nëntë (9) nga interpelancat janë mbajtur, ndërsa tri (3) prej tyre nuk janë mbajtur. Nga interpelancat e mbajtura, tetë (8) prej tyre kanë qenë ndaj kryeministrit z. Isa Mustafa dhe 4 ndaj ministrave të qeverisë.



TABELA 1: DIALOGU NË SEANCAT E LEGJISLATURËS SË PESTË

Nr.	Seanca	Data	Rend Dite/ Diskutim	Çështja e Diskutimit
	vazhdim	8 dhjetor 2014	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë;
1	E jashtëzakonshme	8 dhjetor 2014	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Zbatimi i marrëveshjeve; Rritja e rolit të Kuvendit në Dialog;
2	Plenare	18 dhjetor 2014	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Personat e pagjetur;
3	E jashtëzakonshme	19 janar 2015	Diskutim	Diskutimi i Trepçës në dialog;
4	Plenare	23 janar 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Personat e pagjetur; Kerkim falja nga Serbia;
5	Plenare	5 shkurt 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Asociacioni i komunave serbe; Menaxhimi i integruar i kufirit me Serbinë; Strukturat paralele; Diskutimi i Trepçës në dialog; Telekomunikacioni;
6	Plenare	12 shkurt 2015	Rend Dite	Informimi i kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa, për takimin me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel, më 9 shkurt 2015
7	Solemne	17 shkurt 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Marrëveshja për Drejtësi;
8	Plenare	26 shkurt 2015	Diskutim	Kthimi i artefakteve nga Serbia; Informimi i Kuvendit rreth dialogut; Personat e pagjetur;
9	Plenare	12 mars 2015	Diskutim	Personat e pagjetur;
10	Plenare	26 mars 2015	Diskutim	Implementimi i marrëveshjeve të arritura deri në mars 2015; Personat e pagjetur;
11	Plenare	27 mars 2015	Diskutim	Normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë; Marrëveshja për drejtësi;
12	Plenare	2 prill 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë; Zbatimi i marrëveshjeve; Marrëveshja për shënimet kadastrale; Shtrirja e sovranitetit në dogana; Përcaktimi i temave të dialogut;
	vazhdim	7 prill 2015	Rend Dite	Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës
13	Plenare	16 prill 2015	Rend Dite	Propozimi i GP të PDK-së dhe GP të LDK-së për caktimin e deputetit Blerim Shala në delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë
14	E veçantë	27 prill 2015	Diskutim	Personat e pagjetur; Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë;
15	Plenare	6 maj 2015	Rend Dite	Debat parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginën e Preshevës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, mbështetur edhe nga gjashtë deputetë tjerë
	vazhdim	8 maj 2015	Rend Dite	Debat parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginën e Preshevës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, mbështetur edhe nga gjashtë deputetë tjerë
16	Plenare	18 maj 2015	Diskutim	Marrëveshja për Drejtësinë;

Nr.	Seanca	Data	Rend Dite/ Diskutim	Çështja e Diskutimit
17	Plenare	21 maj 2015	Diskutim	Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve; Fondi për Veriun; Strukturat paralele; Marrëveshja për Drejtësinë; Kartoni i Gjelbër për Kosovën;
18	Plenare	4 qershor 2015	Diskutim	E ardhmja e Liqenit të Gazivodës në kuadër të bisedimeve;
19	E jashtëzakonshme	18 qershor 2015	Rend Dite	Ndalimi në Slloveni i kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe deputetit të Kuvendit të Kosovës, Ramush Haradinaj, sipas një fletarrestimi të Serbisë
20	Plenare	25 qershor 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; IBM me Serbinë; Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve; Asociacioni i komunave serbe; Kompensimet e dëmeve të luftës nga Serbia; Demarkacioni me Serbinë;
21	Plenare	26 qershor 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Asociacioni i komunave serbe; Fusnota; Marrëveshja e Parë e Parimeve për normalizim të marrëdhënieve;
22	Plenare	9 korrik 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi;
23	Plenare	16 korrik 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Strukturat paralele; Asociacioni i komunave serbe;
24	Plenare	23 korrik 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Delegacioni i Kosovës në dialog; Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve; Asociacioni i Komunave Serbe; Strukturat Paralele;
25	Plenare	3 gusht 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve;
	vazhdim	17 shtator 2015	Rend Dite	Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Marrëveshjet e arritura në Bruksel më 25 gusht 2015.
26	Plenare	22 shtator 2015	Rend Dite	Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Marrëveshjet e arritura në Bruksel më 25 gusht 2015
27	Plenare	2 nëntor 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Fusnota; Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve; Asociacioni i Komunave serbe;
28	E veçantë	6 nëntor 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi dhe zbatimimi i marrëveshjeve të arritura;
29	Plenare	14 dhjetor 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Zbatimimi i marrëveshjeve të dialogut; Asociacioni i Komunave serbe;
30	E veçantë	17 dhjetor 2015	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Strukturat paralele; Asociacioni i komunave serbe; Personat e pagjetur; Kthimi i fondit pensional nga Serbia;
31	Plenare	19 shkurt 2016	Diskutim	Raportet Kosovë- Serbi;
32	E jashtëzakonshme	26 shkurt 2016	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve; Asociacioni i Komunave serbe; Personat e pagjetur;
33	Plenare	10 mars 2016	Diskutim	Tekstet shkollore për Luginën e Preshevës; Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve; Asociacionin e komunave me shumicë serbe;

|||||

Nr.	Seanca	Data	Rend Dite/ Diskutim	Çështja e Diskutimit
34	Plenare	24 mars 2016	Diskutim	Kompensimi i dëmeve të luftës nga Serbia; Asociacioni i komunave serbe;
35	Solemne	7 prill 2016	Diskutim	Dialogu në përgjithësi;
36	Plenare	28 prill 2016	Diskutim	Pesonat e pagjetur; Tekstet shkollore për Luginën e Preshevës; Zgjedhjet e Serbisë në Kosovë;
37	Solemne	5 maj 2016	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Asociacioni i Komunave serbe;
38	Plenare	25 maj 2016	Rend Dite	Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
39	Plenare	9 qershor 2016	Rend Dite	Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
40	Plenare	16 qershor 2016	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Strukturat paralele; Asociacioni i Komunave serbe;
41	Plenare	7 korrik 2016	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Marrëveshja për Energjinë; Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve; Integrimi i Mbrojtjes Civile; Asociacioni i Komunave serbe; Strukturat Paralele; Marrëveshja për Drejtësinë; Mbajtja e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë;
42	Plenare	14 korrik 2016	Diskutim	Marrëveshja për Drejtësinë;
43	Plenare	4 gusht 2016	Diskutim	Asociacioni i Komunave serbe;
44	Plenare	22 shtator 2016	Diskutim	Marrëveshja për lëvizjen e lirë; Reciprociteti për tekstet shkollore; Zbatimi i marrëveshjes për kodin telefonik; Strukturat paralele; Asociacioni i Komunave serbe;
45	Plenare	29 shtator 2016	Rend Dite	1. Interpelanca e Kryeministrit, Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 6 deputetë nënshkrues, në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës; 2. Interpelanca e Kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 7 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës
46	Plenare	11 tetor 2016	Rend Dite	1. Votimi i Propozim-Rezolutës lidhur me Kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës; 2. Votimi i Propozim-Rezolutës lidhur me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës
47	E jashtëzakonshme	11 tetor 2016	Rend Dite	Debat parlamentar me rastin e arrestimit të Drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi nga ana e autoriteteve të Serbisë.
	vazhdim	12 tetor 2016	Rend Dite	1. Votimi i Rezolutës së propozuar nga grupet parlamentare të VV-së, AAK-së dhe NISMA-s, për lirin e menjëhershëm nga Serbia të z. Nehat Thaçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës; 2. Votimi i Rezolutës së propozuar nga PDK, LDK dhe 6+, për lirin e menjëhershëm nga Serbia të z. Nehat Thaçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës.

|||||

|||||

Nr.	Seanca	Data	Rend Dite/ Diskutim	Çështja e Diskutimit
48	E jashtëzakonshme	27 tetor 2016	Diskutim	Ngritja e çështjes së krimeve të luftës nga Serbia në dialog; Asociacioni i Komunave serbe;
49	Plenare	28 tetor 2016	Diskutim	Strukturat Paralele; Asociacioni i Komunave serbe;
50	Plenare	30 nëntor 2016	Diskutim	Financimi i Dialogut;
51	E jashtëzakonshme	20 dhjetor 2016	Diskutim	Asociacioni i Komunave serbe;
52	Plenare	22 dhjetor 2016	Diskutim	Ndërtimi i murit në Mitrovicë; Agjenda e Dialogut; Kodi Telefonik; Asociacioni i Komunave serbe;
53	Plenare	23 dhjetor 2016	Diskutim	IBM me Serbinë; Asociacioni i Komunave serbe;
54	Plenare	23 dhjetor 2016	Rend Dite	Debat parlamentar lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën Veriore të Mitrovicës, sipas kërkesës së Grupit parlamentar të AAK-së.
	vazhdim	29 dhjetor 2016	Rend Dite	"Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën Veriore të Mitrovicës."
55	E jashtëzakonshme	10 janar 2017	Rend Dite	Debat parlamentar në lidhje me mbajtjen në arrest të kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë
56	Plenare	19 janar 2017	Diskutim	Kërkesë për ndërprerjen e dialogut; Marrëveshjet e dialogut në kundërshtim me Kushtetutën; Kërkesa ndaj qeverisë për raportim në Kuvend rreth Dialogut; Marrëveshja për kodin telefonik; Asociacioni i Komunave serbe; Ndërtimi i murit në Mitrovicë; Strukturat Paralele;
57	Plenare	9 shkurt 2017	Rend Dite	Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë
	vazhdim	14 shkurt 2017	Rend Dite	Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë
	vazhdim	27 shkurt 2017	Rend Dite	Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë
58	Plenare	2 mars 2017	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Faza e re e Dialogut; Rezoluta për Ramush Haradinaj/pezullimi i Dialogut; Personat e pagjetur; Strukturat Paralele;
	vazhdim	9 mars 2017	Rend Dite	Votimi i propozim - rezolutës për lirim të Ramush Haradinajt
59	Plenare	30 mars 2017	Rend Dite	Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-137 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor
60	Plenare	11 prill 2017	Diskutim	Dialogu në përgjithësi; Shqetesimi për përfshirjen e çështjes së Ushtrisë së Kosovës në dialog;
61	Solemne	13 prill 2017	Diskutim	Dialogu në përgjithësi;
62	Plenare	19 prill 2017	Diskutim	Kthimi i Fondit pensional nga Serbia; Asociacioni i Komunave serbe;
63	Plenare	10 maj 2017	Diskutim	Marrëveshja për Asociacionin e Komunave serbe; Kodi telefonik;

|||||

Tema e dialogut u përmend për herë të parë qysh në seancën konstituive të Kuvendit, konkretisht gjatë vazhdimit të saj me 8 dhjetor 2014, kur kryetari i zgjedhur i Kuvendit z. Kadri Veseli e përmendi në fjalimin e tij marrëveshjen e Brukselit, të cilës iu referua si marrëveshje historike.² Tema e dialogut u lakua sërish në po të njëjtën ditë gjatë seancës së jashtëzakonshme në të cilën u zgjedh qeveria e Kosovës. Edhe kryeministri i zgjedhur atë ditë z. Isa Mustafa përmendi çështjen e dialogut në fjalimin e tij, në të cilin deklaroi se si qeveri ishin të vetëdijshëm për rëndësinë e vazhdimit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel dhe angazhimin për arritjen e marrëveshjeve të reja në përputhje me interesin shtetëror. Ai po ashtu u zotua se qeveria e tij do t'a rriste rolin e Kuvendit në procesin e dialogut, në mënyrë që të gjitha vendimet nga dialogu të ishin transparente dhe të pranueshme nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.³

Kjo temë vazhdoi me diskutimet e deputetëve të cilët qysh në këtë seancë kritikuan qeverinë për qasjen ndaj këtij procesi. Pas këtyre dy seancave, çështjet lidhur me dialogun u diskutuan edhe në katër (4) seanca tjera pasuese. Megjithatë, për herë të parë tema e dialogut ishte si pikë e rendit të ditës rreth dy muaj pas konstituimit të Kuvendit, konkretisht në seancën plenare të 12 shkurtit 2015. (Shih Tabelën 1)

Në këtë seancë kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa informoi deputetët lidhur me takimin me kryeministrin e Serbisë të mbajtur në Bruksel më 9 shkurt 2015, në të cilin ishte arritur marrëveshja për drejtësinë. Me këtë rast Kryeministri Mustafa kishte deklaruar se kjo marrëveshje ruante sistemin unik të drejtësisë në vend dhe se marrëveshja ishte në harmoni me Kushtetutën dhe ligjet e vendit. Të njëjtin qëndrim me Kryeministrin ndau edhe kryetari i grupit parlamentar (GP) të PDK-së z. Enver Hoxhaj i cili kishte deklaruar se kjo marrëveshje ruante unitetin e sistemit të drejtësisë dhe karakterin unitar të shtetit të Kosovës. Në anën tjetër partitë opozitare kundërshtojnë këtë marrëveshje. Kryetari i GP të LVV-së z. Visar Ymeri kishte deklaruar se marrëveshja ishte në kundërshtim me Kushtetutën e vendit.⁴ Debati vazhdoi edhe me diskutimet e deputetëve të tjerë të Kuvendit të cilët paraqitën kërkesat e tyre ndaj qeverisë lidhur me këtë marrëveshje dhe procesin e dialogut në përgjithësi.

Teksti i marrëveshjes së drejtësisë u publikua me vonesë në uebfaqen zyrtare të zyrës së kryeministrit, gjegjësisht pas dy viteve nga

nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje. Ajo fillimisht u publikua vetëm në media dhe më pas KDI ka publikuar tekstin e saj në platformën e saj për monitorimin e Kuvendit të Kosovës Vota Ime, në modulën Dialogu Kosovë - Serbi.⁵

Ky ka qenë edhe raportimi i vetëm i Kryeministrit Mustafa rreth dialogut me Serbinë. Me 22 shtator 2015, kryeministri kishte tentuar të raportonte sërish lidhur me marrëveshjen për asociacionin e komunave serbe e arritur me 25 gusht 2015, por ishte penguar nga partitë opozitare LVV, AAK dhe NISMA të cilat hodhën gjësede drejt tij dhe bllokuan foltoren e Kuvendit. Sipas partive opozitare, seanca nuk mund të vazhdonte derisa kryeministri të tërhiqte nënshkrimin nga kjo marrëveshje.⁶ Tërheqja e Kryeministrit Mustafa nga kjo marrëveshje nuk ndodhi dhe ai nuk raportoi më rreth dialogut gjatë kësaj legjislatore. Seancat vijuese të Kuvendit u karakterizuan me përdorimin e gazit lotsjellës nga partitë opozitare me anë të së cilit ato kundërshtojnë marrëveshjen e 25 gushtit si dhe marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi.

Në seancën plenare të 16 prillit 2015, Kuvendi pati si pikë të rendit të ditës edhe një çështje tjetër të lidhur direkt me dialogun e cila kishte të bënte me caktimin e deputetit Blerim Shala si koordinator në delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë. Ai ishte propozuar nga subjektet politike PDK dhe LDK dhe u votua nga Kuvendi me 56 vota për, 1 votë kundër dhe 4 abstenime.⁷

Gjatë kësaj legjislatore Kuvendi pati si pika të rendit të ditës edhe dy projektligje të cilat ndërlihdeshin me dialogun. Njëri prej tyre ishte Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës i cili ishte pikë e rendit të ditës në tri (3) seanca të Kuvendit.⁸ Ky projektligj i cili buronte nga marrëveshja për kadastër e arritur mes Kosovës dhe Serbisë me 2 shtator 2011, u miratua nga Kuvendi i Kosovës 5 vite pas, konkretisht me 9 qershor 2016.

Projektligji i dytë ishte Projektligji nr. 05/L-137 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor i cili u miratua nga Kuvendi me 30 mars 2017. Ky ligj ndërlihdhej me procesin e dialogut Kosovë - Serbi pasi ishte hapur debati lidhur me atë nëse Kosova duhej të prezantohej me fusnotë në këtë forum. Lidhur me këtë, para miratimit të këtij projektligji Kuvendi miratoi edhe një deklaratë përmes të cilës Kuvendi e njihte Kosovën vetëm në bazë të emrit të saj kushtetues si Republikë e Kosovës dhe se kjo deklaratë do t'i bashkëngjitej secilës marrëveshje ndërkombëtare, e cila ratifikohej në Kuvend në të ardhmen.⁹

2 Shih transkriptin e kësaj seance në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2014_12_08_12_5655_al.pdf

3 Shih transkriptin e seancës së jashtëzakonshme të datës 8 dhjetor 2014 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans__2014_12_08_16_5656_al.pdf

4 Shih lajmin në uebfaqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës në, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,6657>

5 Shih tekstin e marrëveshjes për Drejtësi në platformën e KDI-së Vota Ime, Moduli Dialogu Kosovë- Serbi në, <http://votaime.org/Public/Dialog> (qasur me 21.07.2017)

6 Shih transkriptin e mbledhjes së Kuvendit të datës 22 shtator 2015: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2015_09_17_10_6111_al.pdf (qasur me 21.07.2017)

7 Shih transkriptin e kësaj mbledhjeje: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_s_2015_04_16_10_5890_al.pdf (qasur me 21.07.2017)

8 Shih transkriptet e seancave të datës 7 prill 2015, 25 maj 2016 dhe 9 qershor 2016 në, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,159> (qasur me 23.07.2017)

9 Deklarata e miratuar ka përmbajtjen si në vijim: 1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e njeh Kosovën vetëm në bazë të emrit të saj kushtetues si Republikë e Kosovës, 2. Në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen me ligj që i referohet Kosovës sipas emrit të saj kushtetues, dhe 3. Kjo deklaratë do t'i bashkëngjitet secilës marrëveshje ndërkombëtare, e cila ratifikohet në Kuvend nga sot e tutje. Shih transkriptin e kësaj mbledhjeje në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2017_03_30_10_6926_al.pdf



Përveç seancave plenare të cilat kishin si pikë të rendit të ditës temën e dialogut, gjatë legjislaturës së pestë u mbajtën edhe tri (3) seanca të jashtëzakonshme të cilat kishin si pikë të vetme të rendit të ditës këtë temë. Të tri këto seanca u mbajtën me rastin e tri ndalimeve/arrestimeve, dy nga ato të kryetarit të AAK-së z. Ramush Haradinaj një herë në Slloveni dhe më pas në Francë me flet arreste të lëshuara nga Serbia, dhe një seancë tjetër e jashtëzakonshme ishte mbajtur pas arrestimit nga autoritetet e Serbisë të drejtorit të policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës z. Nehat Thaçi. Nga këto debate dolën edhe tri rezoluta për secilin nga rastet në fjalë të cilat u miratuan nga Kuvendi gjatë kësaj legjislature.¹⁰

Me 29 dhjetor 2016, Kuvendi kishte miratuar edhe një rezolutë tjetër lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës. Përveç këtyre rezolutave që u miratuan nga Kuvendi gjatë kësaj legjislature, dy rezoluta tjera të ndërlidhura me dialogun nuk u miratuan nga Kuvendi. Ato ishin propozim-rezoluta lidhur me Kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës dhe propozim-Rezoluta lidhur me situatën politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës (shih detajet më poshtë në seksionin për rezolutat).

Përveç çështjeve të lartpërmendura Kuvendi gjatë legjislaturës së pestë pati si pikë të rendit të ditës edhe një debat parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginën e Preshevës¹¹ dhe tri (3) interpelanca ndaj kryeministrit të Kosovës z. Isa Mustafa, një lidhur me kodin telefonik të Kosovës dhe dy për situatën në Mitrovicë (shih më poshtë seksionin për interpelancat).

Në fund, gjatë legjislaturës së pestë për herë të parë u votua një rezolutë përmes së cilës kërkohet pezullimi i dialogut me Serbinë 6 vite pas fillimit të këtij procesi. Pas kësaj rezolute dialogu u pezullua dhe ai rifilloi rreth 6 muaj pas me takimin e parë në mes të presidentit të Kosovës z. Hashim Thaçi dhe presidentit të Serbisë z. Aleksandar Vuçiç me 31 gusht 2017 në Bruksel. Ky takim shënoi edhe fillimin e një faze të re të dialogut mes dy shteteve.



Në fund, gjatë legjislaturës së pestë për herë të parë u votua një rezolutë përmes së cilës kërkohet pezullimi i dialogut me Serbinë 6 vite pas fillimit të këtij procesi. Pas kësaj rezolute dialogu u pezullua dhe ai rifilloi rreth 6 muaj pas me takimin e parë në mes të presidentit të Kosovës z. Hashim Thaçi dhe presidentit të Serbisë z. Aleksandar Vuçiç me 31 gusht 2017 në Bruksel. Ky takim shënoi edhe fillimin e një faze të re të dialogut mes dy shteteve.

(qasur me 21.07.2017)

¹⁰ Rezoluta pas ndalimit në Slloveni të kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe deputetit të Kuvendit të Kosovës, Ramush Haradinaj, sipas një fletarrestimi të Serbisë, u miratua nga Kuvendi në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur me 18 qershor 2015, Shih transkriptin e kësaj seance në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_2015_06_18_10_6022a.pdf (qasur me 21.07.2017). Rezoluta pas arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë u miratua nga Kuvendi gjatë vazhdimit të seancës së jashtëzakonshme me 12 tetor 2016. Shih lajmin e Kuvendit për këtë seancë në, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,8325> (qasur me 21.07.2017), dhe, rezoluta tjetër për z. Ramush Haradinaj pas ndalimit të tij në Francë, u miratua nga Kuvendi gjatë vazhdimit të seancës plenare me 9 mars 2017. Shih lajmin e Kuvendit për këtë seancë në <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,8772> (qasur me 21.07.2017)

¹¹ Çështja e shpërndarjes së teksteve shkollore për Luginën e Preshevës është shtruar në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë në takimin e 29 shtatorit 2015 nga ministrit e qeverisë znj. Edita Tahiri dhe z. Arsim Bajrami, të cilët kishin kërkuar ndihmën e BE-së që dërgesa e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të zhbllokohej dhe të dërgohej tek studentët. Ata kishin konfirmuar zbatimin e reciprocitetit për këtë çështje. Shih këtë takim në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,5259>



3. MBIKQYRJA PARALMENTARE E DIALOGUT KOSOVË – SERBI

3.1. Interpelancat

Interpelanca është një instrument të cilin e kanë në dispozicion deputetët për të mbikëqyrur punën e ekzekutivit, gjegjësisht Kryeministrit dhe ministrave të kabinetit qeveritar. Sipas Rregullorës së Punës së Kuvendit, një grup parlamentar ose gjashtë (6) e më shumë deputetë mund të parashtrojnë kërkesë për interpelancë për ta shqyrtuar një çështje, që lidhet me punën e Qeverisë ose të një Ministrie.¹²

Përgjatë legjislaturës së pestë të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë realizuar gjithsej nëntë interpelanca parlamentare, prej të cilave vetëm tri ishin të dedikuara për çështje të ndërlidhura me dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Dy interpelancat e para janë zhvilluar në të njëjtën ditë, në seancën plenare të mbajtur me datën 29 shtator 2016, ku pika e gjashtë dhe e shtatë e rendit të ditës së kësaj seance ishin të parapara për realizimin e interpelancave.¹³ Ndërsa, interpelanca e tretë është mbajtur në kuadër të seancës plenare të mbajtur me datën 9 shkurt 2016.¹⁴

Interpelanca e parë u zhvillua ndaj kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 6 deputetë nënshkrues, lidhur me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës. Deputeti Visar Ymeri, në emër të grupit të deputetëve nënshkrues, tha se kodin telefonik sipas marrëveshjes së nënshkruar nga kryeministri Isa Mustafa i konvenon Serbisë, sepse Kosova nuk po bëhet anëtare e ITU-s, e Serbia ia cakton këtë kod Kosovës.

Për më tepër, sipas deputetit Ymeri, “Republika e Kosovës ka mundur të aplikojë vetë në ITU, sipas nenit 2, pika c) e Kushtetutës së ITU-s, dhe se Republika e Kosovës ka mundur ta shfrytëzojë kodin +355 të Republikës së Shqipërisë, duke e zbatuar Rezolutën e Kuvendit që ishte nxjerrë më herët për këtë çështje”.¹⁵ Për fund, z.Ymeri deklaroi se Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur në kundërshtim me vullnetin e Kuvendit.

Ndërkaq, Kryeministri Mustafa sa i përket kësaj çështje kishte deklaruar se kodi ndërkombëtar telefonik i Kosovës ka rëndësi të madhe shtetërore, sepse i jep Kosovës sovranitet ndërkombëtar në sektorin e telekomunikacionit dhe përbën një prej simboleve të rëndësishme për vendin. Kryeministri Mustafa kishte potencuar se në kuadër të dialogut me Serbinë në Bruksel, Kosova kishte arritur marrëveshjen për telekomunikacionin, e cila i siguron Kosovës kodin telefonik shtetëror. z.Mustafa poashtu kishte deklaruar Kosova do ta ketë kodin e vet telefonik shtetëror nga ITU-ja, Unitetit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve dhe ky kod do të jetë +383. Për këtë pikë të rendit të ditës kishin diskutuar edhe deputetët Besim Beqaj, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Pal Lekaj, Enver Hoti, Faton Topalli, Bali Muharremaj, Shukri Buja, Haxhi Shala, Visar Ymeri, Teuta Haxhiu, Rexhep Selimi dhe Albin Kurti.

Në emër të propozuesit të interpelancës, deputeti Visar Ymeri e paraqiti për miratim një Rezolutë prej 3 pikave, ku kërkohet përdorimi i kodit telefonik të Shqipërisë. Megjithatë, kjo Rezolutë nuk arriti të votohej për shkak të mungesës së kuorumit.

12 Rregullorja e Punës së Kuvendit, neni 44(1): https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_1.pdf (qasur me 12.08.2017)

13 Kuvendi i Republikës së Kosovës, rendi i ditës nga seanca e dates 29 shtator 2016: <http://kuvendikosoves.org/?cid=1.159.6629> (qasur me 12.08.2017)

14 Kuvendi i Republikës së Kosovës, rendi i ditës nga seanca e dates 09 shkurt 2017: <http://kuvendikosoves.org/?cid=1.159.6844> (qasur me 12.08.2017)

15 Transkripti i seancës parlamentare të mbajtur me datën 29 shtator 2016: http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2016_09_29_10_6629_al.pdf (qasur me 12.08.2017)

Në të njëjtën seancë plenare, Kryeministri Mustafa u përgjigj edhe në një interpelancë tjetër, kësaj rradhe sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 7 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Në adresimin e tij para deputetëve të Kuvendit, deputeti Kurteshi përmendi shumë çështje të cilat konsideroheshin si problematike sa i përket shtrimin të sovranitetit në pjesën veriore të vendit. Z.Kurteshi potencoi se populli shqiptar vazhdon të dëbohet nga pjesa veriore e vendit, strukturat paralele serbe funksionojnë normalisht, shteti i Serbisë ofron shërbime të rregullta për qytetarët serb që jetojnë në veri, si dhe përmendi ndërtimin e lagjes “Lugina e Diellit”, e cila pritet të jetë lagje e banuar krejtësisht me popullësi serbe.

Kryeministri Isa Mustafa deklaroi se gjendja në veri të vendit nuk ka qenë e mirë për një kohë të gjatë që nga fundi i luftës dhe se këtë gjendje e kemi trashëguar nga UNMIK-u, i cili nuk ka arritur ta shtrijë administrimin në veri të vendit dhe të mos lejojë ndërhyrjen e Serbisë dhe të strukturave paralele.

Kryeministri Mustafa potencoi se Qeveria e Republikës së Kosovës në programin e saj ka vendosur si prioritet strategjik çështjen e normalizimit të gjendjes në veri, shtrirjen dhe konsolidimin e sovranitetit të shtetit në tërë territorin, përfshirë edhe katër komunat në veri të vendit. Në adresimin e tij, Kryeministri Mustafa kishte vlerësuar se me gjithë vështirësitë, progresi në këtë drejtim është substancial dhe është shumë i dukshëm, duke deklaruar se Qeveria e Kosovës ka arritur të vendosë sovranitetin dhe ligjshmërinë në shumë fusha relevante, duke nisur nga vendosja e kufirit me Serbinë, funksionimin e komunave legale, vendosja e autoriteteve shtetërore në dy pikëkalimet kufitare në veri, vendosja e Policisë së Kosovës në komunat e veriut, zhbërja e disa strukturave paralele etj.¹⁶

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan këta deputetë: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP të “Nismës”, si dhe Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Lirije Kajtazi, Rexhep Selimi, Bekim Haxhiu, Teuta Haxhiu, Sadri Ferati, Armend Zemaj dhe Nuredi Ibishi. Edhe në këtë interpelancë, në emër të propozuesit të interpelancës, deputeti Ismajl Kurteshi e paraqiti për miratim një Rezolutë ku kërkohej ndalimi i ndërtimit të lagjes “Lugina e Diellit”, por as kjo Rezolutë nuk u votua për shkak të mungesës së kuorumit.

Edhe interpelanca e tretë, e mbajtur në seancën plenare të datës 9 shkurt 2017, iu kushtua situatës në veri të vendit. Në këtë interpelancë ishte i ftuar Kryeministri Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë. Deputeti Selimi në adresimin e tij përmendi një sërë çështjesh e ngjarjes gjatë asaj periudhe, me theks të veçantë ndërtimin e murit ilegal në veri të Mitrovicës dhe tentimin e hyrjes së trenit ilegal serb në territorin e Republikës së Kosovës. Z.Selimi poashtu deklaroi se këto situata “e dëmtojnë rënd shtetin e Kosovës dhe partneritetin me miqtë tanë perëndimor, u krijojnë hapësirë të favorshme forcave antiperëndimore në Kosovë dhe, mbi të gjitha, rrënon të ardhmen e sigurt të qytetarëve të Kosovës.”¹⁷

Në adresimin e tij në këtë interpelancë, Kryeministri Mustafa kishte deklaruar se Qeveria e Kosovës është duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të normalizuar situatën në veri dhe për të ruajtur sovranitetin e vendit. Kryeministri Mustafa deklaroi poashtu se janë dy probleme, të cilat e ngarkojnë jo vetëm situatën në veri të vendit: shtrirja e gjerë e strukturave paralele serbe në shumë komuna si dhe ndikimi i drejtpërdrejtë i Qeverisë së Serbisë në deputetët e Kuvendit dhe anëtarët e Qeverisë nga radhët e Listës serbe. Kryeministri Mustafa poashtu deklaroi se marrëveshjet e Brukselit kanë pasur impakt pozitiv në shumë aspekte, dhe se Kosova ka arritur të shtrijë sovranitetin e saj në veri të vendit në këto fusha: në fusha të sigurisë, ku Policia e Kosovës vepron nga viti 2014, në fushën e Doganave nga viti 2012, dhe në fushën e Administratës Tatimore.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan këta deputetë: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Albin Kurti, në emër të GP LVV; Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma”, Qerim Bajrami, në emër të GP “6+” si dhe deputetët: Faton Topalli, Raif Qela, Vjosa Osmani-Sadriu, Rrustem Berisha, Blerta Deliu-Kodra, Sadri Ferati, Ismajl Kurteshi, Ali Berisha, Enver Hoti, Abdyl Ymeri, Anton Quni, Ilir Deda, Glauk Konjufca, Muhamet Mustafa, Emilijja Rexhepi, Adem Salihu, ministrija Edita Tahiri, Ganimete Musliu, Sabri Hamiti, Shpejtim Bulliqi, Beikm Haxhiu dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli.

Deputeti Rexhep Selimi, i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, kishte propozuar për miratim rezolutën prej 5 pikave. Mirëpo, teksti i kësaj Rezolute nuk ishte harmonizuar mes Grupeve Parlamentare, dhe kësajsoji u kërkua që kjo rezolutë të votohet në një seancë tjetër.

¹⁶ Ibid (4)

¹⁷ Transkripti i seancës parlamentare të mbajtur me datën 9 shkurt 2017: http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2017_02_09_10_6844_al.pdf (qasur me 12.08.2017)

3.2 Pyetjet Parlamentare rreth Dialogut



Pyetjet parlamentare janë një nga mekanizmat kryesor që kanë në dispozicion deputetët e Kuvendit për të kërkuar llogari nga ekzekutivi lidhur me punët e (pa)kryera të Ministrive përkatëse. Përmes pyetjeve parlamentare, deputetët e Kuvendit trajtojnë çështje specifike për të cilat ka interesim të veçantë nga deputetët. Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit¹⁸, rendi i ditës për secilën mbledhje të Kuvendit parasheh 60 minuta kohë për pyetje parlamentare, ku deputeti për një mbledhje plenare mund të parashtrijë më së shumti dy pyetje.

Megjithatë, pavarësisht mundësisë së realizimit të kësaj të drejte, deputetët e legjislaturës së pestë në përgjithësi ishin joaktiv sa i përket realizimit të kësaj të drejte, ku përgjatë gjithë mandatit të tyre kanë parashtruar vetëm 428 pyetje parlamentare. Nga numri total i pyetjeve parlamentare të parashtruara nga deputetët, vetëm 28 e pyetjeve kanë qenë të ndërlidhura me procesin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

Nga 28 pyetjet parlamentare të parashtruara nga deputetët lidhur me çështjen e dialogut, 50% e tyre (14 pyetje) kanë marrë përgjigje nga ana e ekzekutivit (Shih tabelën numër 2).

Më së shumti pyetje janë parashtruar për Kryeministrin Isa Mustafa, gjithësej 11, ndjekur nga ministrja për dialog Edita Tahiri, e cila pranoi 7 pyetje dhe ministri i arsimit, Arsim Bajrami, të cilit ju parashtruan 4 pyetje. Dy pyetje rreth procesit të dialogut u parashtruan edhe për ministrin e kulturës, Kujtim Shala, kurse nga një pyetje u parashtrua për ministrin e punëve të brendshme Skender Hyseni, Ministrin e drejtësisë Hajredin Kuçi, ministrin e punës dhe mirëqenies sociale Arban Abrashi dhe ministrin e pushtetit lokal Lubomir Mariq.

Ministrja për Dialog, Edita Tahiri, është përgjigjur më së shpeshi në pyetjet parlamentare të cilat i janë drejtuar, duke u përgjigjur në 5 nga 7 pyetjet e parashtruara për të. Kryeministri Isa Mustafa ka ofruar përgjigje në vetëm 3 nga 11 pyetjet e parashtruara, kurse ministri Bajrami është përgjigjur në 3 nga 4 pyetjet e parashtruara. Ministra tjerë që u përgjigjën në pyetjet e parashtruara për ta ishin edhe Skënder Hyseni, Arban Abrashi dhe Kujtim Shala, ku secili u përgjigj në nga një pyetje parlamentare.

Sa i përket parashtruesve të pyetjeve parlamentare, deputeti më aktiv në këtë drejtim ishte Ismajl Kurteshi nga Lëvizja Vetëvendosje, i cili ka parashtruar 12 nga 28 pyetjet parlamentare të ndërlidhura me dialogun. Pesë deputetë të tjerë kishin parashtruar nga dy pyetje parlamentare: Blerta Deliu-Kodra dhe Abdyl Ymeri nga PDK,

Më së shumti pyetje parlamentare nga ana e deputetëve u adresuan lidhur me funksionimin dhe shuarjen e strukturave paralele në veri të vendit dhe bllokimin e teksteve shkollore të destinuara për nxënësit shqiptar në Luginën e Preshevës nga ana e Serbisë, nga 5 për secilën çështje.

Alma Lama nga LDK, Donika Kadaj-Bujupi nga LVV dhe Teuta Haxhiu nga AAK. Kurse, gjashtë deputetë parashtruan nga një pyetje parlamentare të ndërlidhur me dialogun: Ganimete Musliu (PDK), Rexhep Selimi, Faton Topalli, Besa Baftiu, Aida Dërguti (LVV) dhe Time Kadrijaj (AAK). Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka realizuar më së shumti pyetje parlamentare, 18 nga gjithësej 28 sa janë parashtruar në total rreth dialogut, ndjekur nga GP i PDK-së me 5 pyetje parlamentare, GP i AAK-së me 3 pyetje dhe GP i LDK-së me 2. Grupet tjera parlamentare nuk kanë parashtruar asnjë pyetje parlamentare që ndërlidhet me procesin e dialogut mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Më së shumti pyetje parlamentare nga ana e deputetëve u adresuan lidhur me funksionimin dhe shuarjen e strukturave paralele në veri të vendit dhe bllokimin e teksteve shkollore të destinuara për nxënësit shqiptar në Luginën e Preshevës nga ana e Serbisë, nga 5 për secilën çështje. Çështje tjera specifike për të cilat u parashtruan pyetje parlamentare ishin mbarëvajtja dhe e ardhmja e dialogut (3 pyetje), themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe (3 pyetje), personat e pagjetur, kodi telefonik dhe lëvizja e lirë (2 pyetje) si dhe pyetje të tjera të ndërlidhura me shtrirjen e sovranitetit në gjithë territorin e vendit, përbërjen e delegacionit për negociatat e Brukselit, projektin për "Luginën e Diellit".

¹⁸ Rregullorja e Punës së Kuvendit, neni 45(1). Shih: https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_1.pdf (qasur me 12.08.2017)

|||||

TABELA 2: PYETJET PARLAMENTARE RRETH DIALOGUT

Pyetja	Data	Parashtruesi	Drejtuar për	Përgjigjur	Çështja
1	2 mars 2017	Blerta Deliu - Kodra	Edita Tahiri	Jo	Të pagjeturit
2	2 mars 2017	Blerta Deliu - Kodra	Isa Mustafa	Po	Faza e re e dialogut
3	9 shkurt 2017	Abdyl Ymeri	Edita Tahiri	Po	Kodi telefonik
4	9 shkurt 2017	Time Kadrijaj	Edita Tahiri	Po	E ardhmja e dialogut
5	19 janar 2017	Abdyl Ymeri	Edita Tahiri	Jo	Kodi telefonik
6	29 shtator 2016	Ganimete Musliu	Skender Hyseni	Po	Liria e lëvizjes
7	22 shtator 2016	Ismajl Kurteshi	Arsim Bajrami	Po	Tekstet mësimore
8	22 shtator 2016	Rexhep Selimi	Edita Tahiri	Po	Liria e lëvizjes
9	4 gusht 2016	Ismajl Kurteshi	Isa Mustafa	Jo	Strukturat paralele
10	7 korrik 2016	Ismajl Kurteshi	Edita Tahiri	Po	Strukturat paralele
11	16 qershor 2016	Donika Kadaj - Bujupi	Isa Mustafa	Jo	Lugina e diellit
12	16 qershor 2016	Faton Topalli	Isa Mustafa	Jo	Pyetje me shkrim
13	10 mars 2016	Alma Lama	Arsim Bajrami	Po	Tekstet mësimore
14	19 shkurt 2016	Ismajl Kurteshi	Hajredin Kuçi	Jo	Asociacioni i Komunave Serbe
15	19 shkurt 2016	Ismajl Kurteshi	Kujtim Shala	Jo	Tekstet mësimore
16	19 shkurt 2016	Ismajl Kurteshi	Ljubomir Marić	Jo	Strukturat paralele
17	19 shkurt 2016	Ismajl Kurteshi	Arsim Bajrami	Jo	Tekstet mësimore
18	19 shkurt 2016	Ismajl Kurteshi	Isa Mustafa	Jo	Strukturat paralele
19	19 shkurt 2016	Ismajl Kurteshi	Isa Mustafa	Jo	Asociacioni i Komunave Serbe
20	17 shtator 2015	Donika Kadaj - Bujupi	Isa Mustafa	Jo	Shtrirja e sovranitetit në veri
21	23 korrik 2015	Ismajl Kurteshi	Isa Mustafa	Po	Përbërja e delegacionit
22	21 maj 2015	Ismajl Kurteshi	Isa Mustafa	Jo	Strukturat paralele
23	6 maj 2015	Besa Baftiu	Isa Mustafa	Jo	E ardhmja e dialogut
24	16 prill 2015	Teuta Haxhiu	Arsim Bajrami	Po	Tekstet mësimore
25	26 mars 2015	Ismajl Kurteshi	Edita Tahiri	Po	Integrimi i veriut
26	12 mars 2015	Teuta Haxhiu	Isa Mustafa	Po	Të pagjeturit
27	26 shkurt 2015	Alma Lama	Kujtim Shala	Po	Kthimi i artefakteve nga Serbia
28	5 shkurt 2015	Aida Derguti	Arban Abrashi	Po	Asociacioni i Komunave Serbe

|||||



3.3 Pyetjet e qytetarëve për deputetët te votaime.org seksioni ‘Pyet deputetit?’ lidhur me procesin e dialogut

Përmes platformës Votaime.org, qytetarët e Republikës së Kosovës kanë mundësinë unike për t'u parashtruar pyetje të zgjedhurve të tyre për çështjet për të cilat ata preokupohen. Në përgjithësi, qytetarët e vendit kanë shfrytëzuar këtë platformë dhe kanë parashtruar gjithësej 82 pyetje për deputetët, ku 12 prej tyre kanë qenë të ndërlidhura me procesin dhe temat e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Nga 12 pyetje të parashtruara për dialogun me Serbinë, vetëm 3 nga to kanë marrur përgjigje nga deputetët. Deputetët e vetëm të cilët janë përgjigjur në pyetjet e qytetarëve rreth dialogut janë Vjosa Osmani dhe Teuta Sahatqija nga LDK dhe Albulena Haxhiu nga LVV. Deputetët Vjosa Osmani, Albin Kurti dhe ish-Kryetari i Kuvendit Kadri Veseli kanë pranuar më së shumti pyetje nga qytetarët, nga dy secili. Deputetë të tjerë ndaj të cilëve u parashtruan pyetje nga qytetarët rreth procesit të dialogut ishin Albulena Haxhiu, Glauk Konjufca, Xhavit Haliti, Teuta Sahatqija etj.

Pyetjet më të shpeshta të qytetarëve të parashtruara te votaime.org në seksionin ‘Pyet deputetin?’ rreth procesit të dialogut kishin të bëjnë me strukturat paralele, krijimin e Asociacionin të Komunave Serbe, marrëveshjen për kodin telefonik, raportimin e ministrave në Kuvend dhe të ardhmen e procesit të dialogut.



Për herë të parë Kuvendi i Kosovës që nga aprovimi i Rezolutës së parë që i dha fillesë dialogut Kosovë- Serbi kërkoi pezullimin e dialogut Kosovë-Serbi deri në lirimin e z. Haradinaj.

3.4 Propozim Rezolutat dhe Rezolutat rreth Dialogut

Kuvendi i Kosovës në vitin 2011¹⁹ dhe 2012 miratoi Rezoluta me anë të së cilave iu dha fillesë edhe procesit teknik dhe më vonë politik të dialogut Kosovë-Serbi duke mandatuar Qeverinë për të udhëhequr me këtë proces. Gjithashtu Kuvendi i Kosovës obligoi Qeverinë të raportoj në mënyrë të rregullt mbi këtë proces dhe të përfshij Komisionet parlamentare në këto diskutime në bazë të temave.²⁰

Rezolutat nuk janë detyruese, por shprehin vullnetin e deputetëve drejtuar institucioneve të tjera andaj dhe ato duhen respektuar. Gjatë legjislaturës së pestë të Kuvendit të Kosovës deputetët kanë iniciuar 7 propozim Rezoluta rreth dialogut Kosovë- Serbi, nga të cilat 4 propozim Rezoluta janë miratuar.

3.4.1 Rezoluta Nr. 05-R-02 lidhur me ndalimin e deputetit Ramush Haradinaj në Slloveni

Gjatë vitit 2015, Kuvendi i Kosovës diskutoi rreth ndalimit të deputetit të atëhershëm të Kuvendit dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës z. Ramush Haradinaj nga autoritetet sllovene në Lubjanë me propozim të Grupit Parlamentar të AAK-së.²¹

Kuvendi aprovoi më 18 Qershor 2015, Rezolutën me të cilën i drejtohej Qeverisë dhe Presidencës për ndërmarrjen e veprimeve për lirimin e menjëhershme dhe të pakusht të z. Haradinaj. Si dhe kërkonte nga Qeveria e Kosovës të diskutonte në mënyrë urgjente me Brukselin rreth pastrimit të listave dhe fletarrestimeve të lëshuara nga Serbia për ish ushtarët e UÇK-së.

3.4.2 Rezoluta Nr. 05-R-05, lidhur me arrestimin e zotit Nehat Thaçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës, nga autoritetet e Serbisë

Çështja e ndalimit të zyrtarëve të shtetit të Kosovës nga autoritetet e Serbisë do të shtynin Kuvendin e Kosovës të diskutonte në seancë të jashtëzakonshme më 11 dhe 12 tetor 2016, me pikën e vetme të

19 Rezoluta për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rezoluta_Nr_04-R-001_e_Kuvendit_t%C3%AB_Kosov%C3%ABs_p%C3%ABr_dialogun_midis_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_dhe_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Serbis%C3%AB_dat%C3%AB_10.03.2011.pdf

20 Rezoluta për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rezolut%C3%AB_-_P%C3%ABr_normalizimin_e_marr%C3%ABdh%C3%ABnieve_n%C3%AB_mes_t%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_dhe_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Serbis%C3%AB_18.10.2012.pdf

21 Shih rezolutën në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_lidhur_me_ndalimin_e_deputetit_Ramush_Haradinaj_ne_Slloveni.pdf



rendit të ditës “Debat parlamentar me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë”.²²

Gjatë kësaj seance partitë opozitare dhe partitë në koalicionin do të bënin dy propozim Rezoluta të ndryshme duke u ndarë në qëndrimin e tyre rreth ndërlidhjes së të ardhmes së dialogut Kosovë - Serbi me këtë çështje.

Ndërsa partitë opozitare së bashku me deputetin z. Gëzim Kelmendi dhe deputetin e pavarur z. Shaip Muja kërkuan pezullimin e bisedimeve Kosovë-Serbi deri në lirimin e Thaçit dhe deri në zhvlerësimin e të gjitha aktakuzave për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Partitë në koalicion propozuan që Qeveria t’ia bëjnë me dije BE-së se veprimet e Serbisë në raport me institucionet dhe qytetarët e Kosovës po e rrezikojnë thellë përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe dialogun ndërmjet dy vendeve, duke thënë se janë duke e detyruar Kosovën të ndërmarr hapa për reciprocitet.

Të dy propozim Rezolutat kërkuan nga Interpoli që Policia e Kosovës të bëhej pjesë e kësaj organizate dhe të largonte nga sistemi ligjor fletë arrestet politike të shpallura nga Serbia. U kërkuva nga EULEX-i të deklarohej rreth këtij arrestimi dhe të angazhohej drejtpërdrejt si mision me kompetenca të veçanta. Si dhe u kërkuva nga BE, si ndërmjetësues dhe garantues i dialogut të ndërhynte te Qeveria e Serbisë për lirimin e z. Thaçi. Propozim Rezoluta e paraqitur nga Armend Zemaj u aprovua me 51 vota.²³

3.4.3 Rezoluta Nr. 05-R-007, lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën Veriore të Mitrovicës

Ndërtimi i murit në mënyrë ilegale në anën veriore të Mitrovicës së veriut, shtyu Kuvendin e Kosovës të inicioj debat parlamentar lidhur me këtë çështje, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Diskutimi i kësaj çështjeje u cilësua si urgjente dhe u paraqit në seancën e datës 22 dhjetor 2016.

Si karakteristikë e seancave të Kuvendit, shumë pika rendi të ditës, shtyn shefin e grupit parlamentar të AAK-së të propozonte shtyrjen e diskutimit të kësaj teme në seancat pasardhëse, propozim i cili nuk u miratua.

Në këtë debat parlamentar u propozua rezoluta nga ana e AAK-së, miratimi i së cilës u shty për seancat pasardhëse në mung-

esë të kuorimit të mjaftueshëm për të votuar. Diskutimi rreth propozim-rezolutës u mbajt në seancën e datës 29 dhjetor 2016, në të cilën u paraqit nga ana e kryetarit të grupit parlamentar të AAK-së z. Pal Lekaj, e harmonizuar nga grupet parlamentare të AAK-së, PDK-së, LVV-së dhe LDK-së. Rezoluta u votua me 74 vota.²⁴

Në Rezolutë u kërkuva që muri të rrënohet brenda muajit janar 2017. U kërkuva nga Qeveria që të shtyj organet kompetente për të ndërmarr veprimet ligjore për trajtimin e ndërtimeve pa leje, duke e cilësuar si veprim politik dhe ndërtim pa leje. Po ashtu u kërkuva që Qeveria të ndërmarr masat për mos ndryshimin e urës së Ibrit, duke përmblotur të gjitha elementet që i kishte para vitit 1999, duke mos shtuar elemente të rinjë siç është muri dhe shkallët. Ndërsa u kërkuva që të bëhej e mundur që qytetarët të kthehen në pronat e tyre, në të dy pjesët e qytetit të Mitrovicës.

3.4.4 Rezoluta Nr. 05-R-011, lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë

Me ndalimin e z. Ramush Haradinaj më 4 janar 2017, Kuvendi i Kosovës mbajti diskutim në seancë plenare më datë 10 janar në të cilën u propozua Rezoluta me anë të së cilës kërkohej lirim i menjëhershëm i z. Haradinaj, trajtimi i kësaj çështjeje si prioritet shtetëror, ku kërkohej përfshirja direkte e BE-së dhe përfaqësueses së lartë për politikë të jashtme znj. Mogerini.²⁵

Me anë të kësaj Rezolute, Qeveria u obligua të informoj instancat ndërkombëtare që refuzon juridiksionin universal të Serbisë për krimet e pretenduara në tërë territorin e ish Jugosllavisë.

Gjithashtu u kërkuva ndërprerja e bisedimeve me Serbinë deri në anulimin e të gjithë fletarrestimeve të lëshuara nga Serbia ndërsa u kërkuva dorëheqja ose shkarkimi i të gjithë përgjegjësve kryesor të negociatorëve me Serbinë.

Diskutimi u ribë në mars 2017 për shkak të zgjatjes së ndalimit të z. Haradinaj në Francë si rezultat i procesit gjyqësor. Grupi parlamentar i AAK-së propozoi Rezolutën e cila ishte e harmonizuar me grupet parlamentare të PDK, LDK, LVV dhe Nismës, me anë të së cilës kërkohej lirim i pakusht dhe i menjëhershëm i z. Haradinaj.

Për herë të parë Kuvendi i Kosovës që nga aprovimi i Rezolutës së parë që i dha fillësë dialogut Kosovë- Serbi kërkoi pezullimin e dialogut Kosovë-Serbi deri në lirimin e z. Haradinaj.

22 Proceverbali i seancës së jashtëzakonshme të mbajtur me 11 dhe 12 tetor 2016: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2016_10_11_14_6667_al.pdf (qasur me 10.08.2017)

23 Shih këtë rezolutë në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_R-005.pdf

24 Shih këtë rezolutë në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2016_12_30_Rezoluta_nr_007.pdf

25 Shih rezolutën në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2017_03_09_Rezoluta_nr_011_per_lirimin_e_Ramush_Haradinaj.pdf



4. DIALOGU NË KOMISIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS

Gjatë Legjislaturës së Pestë, 15 Komisionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë mbajtur gjithsej 1005 mbledhje²⁶, në të cilat janë diskutuar çështje që bien në fushëveprimin e tyre të përcaktuara me rregulloren e Kuvendit.

Procesi i dialogut Kosovë-Serbi si dhe marrëveshjet e arritura në kuadër të këtij procesi janë trajtuar në 115 mbledhje të Komisioneve parlamentare ku në 27 mbledhje kanë qenë të parapara me rendin e ditës. Shikuar në përqindje, çështjet lidhur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi janë diskutuar në 11% të mbledhjeve të Komisioneve të Kuvendit, ndërsa në vetëm 3% të tyre, këto çështje kanë qenë pjesë e rendit të ditës.²⁷

Komisionet parlamentare të cilat kanë trajtuar më së shumti temën e dialogut Kosovë - Serbi gjatë legjislaturës së pestë kanë qenë, Komisioni për Integritet Evropian, Komisioni për Punë të Jashtme, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si dhe Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. (Shih seksionet e mëposhtme për detaje për çdo Komision).

Komisionet parlamentare në ushtrimin e rolit mbikëqyrës ndaj ekzekutivit në raportime dhe dëgjime publike kanë ftuar Ministrat e Qeverisë në 180 mbledhje. Çështjet që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi janë ngritur në 34 prej këtyre mbledhjeve, ndërsa në vetëm 11 mbledhje ministrat e Qeverisë së Kosovës janë ftuar të raportojnë ekskluzivisht për dialogun Kosovë-Serbi. Ministrja

për Dialog znj. Edita Tahiri ka raportuar gjithsej tetë (8) herë në Komisionet e Kuvendit gjatë legjislaturës së pestë. Prej tyre ajo ka raportuar tri (3) herë në Komisionin për Punë të Jashtme, dy (2) herë në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe nga një (1) herë në Komisione tjera të Kuvendit.

Shikuar në përqindje, Ministrat e qeverisë kanë raportuar ekskluzivisht për dialogun në 6% të mbledhjeve të Komisioneve, ndërsa në 19% të mbledhjeve ku ata kanë qenë të ftuar janë ngritur çështjet e ndërlidhura me dialogun Kosovë-Serbi.

4.1 Komisioni për Buxhet dhe Financa

Gjatë Legjislaturës së Pestë, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur gjithsej 84 takime²⁸ ku janë diskutuar tema që bien në fushëveprimin e këtij Komisioni, konform Rregullores së Kuvendit të Kosovës. Çështje të cilat ndërlidhen me procesin e dialogut Kosovë - Serbi janë diskutuar në nëntë (9) mbledhje të këtij Komisioni duke e përfshirë vetëm 1 (një) herë si pjesë të rendit të ditës (Shih Tabelën 3).

Tema më e diskutuar në këtë Komision lidhur me dialogun Kosovë - Serbi ka qenë Fondi Zhvillimor (për Veriun) e cila është diskutuar në

²⁶ Për 42 nga këto mbledhjet të Komisioneve nuk ka pasur lajme në ueb faqen e Kuvendit se janë mbajtur edhe pse ato kanë qenë të planifikuara sipas kalendarit. Numri i mbledhjeve i paraqitur nga KDI është sipas kalendarit të takimeve në ueb faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës.

²⁷ Vërejtje: Duke qenë se procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë nuk janë publike, nuk dihet nëse ky Komision ka trajtuar çështje lidhur me procesin e Dialogut Kosovë - Serbi në mbledhjet e tij. Prandaj, KDI e ka përfshirë në llogaritjet vetëm numrin e mbledhjeve të mbajtura nga ky Komision dhe nuk e ka përfshirë këtë Komision në llogaritjet e përqindjes.

²⁸ Për katër (4) prej këtyre mbledhjeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk ka pasur lajme në ueb faqen e Kuvendit se janë mbajtur edhe pse ato kanë qenë të planifikuara sipas kalendarit. Numri i mbledhjeve i paraqitur nga KDI është sipas kalendarit të takimeve në ueb faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës.



TABELA 3: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR BUXHET DHE FINANCA

Mbledhja	Data	Rend dite/Diskutim	Çështja e Diskutimit
1	19.12.2014	Diskutim	Fondi për Veriun; I ftuar: Ministri i Financave z. Avdullah Hoti
2	23.12.2014	Diskutim	Fondi për Veriun; I ftuar: Ministri i Financave z. Avdullah Hoti
3	24.12.2014	Diskutim	Fondi për Veriun; I ftuar: Ministri i Financave z. Avdullah Hoti
4	13.05.2015	Diskutim	Shtirja e doganave të Kosovës në Veri
5	20.05.2015	Diskutim	Policat e Sigurimit/Kartoni i Gjellbër; I ftuar: Ministri i Financave z. Avdullah Hoti
6	16.09.2015	Diskutim	Fondi për Veriun; I ftuar: Ministri i Financave z. Avdullah Hoti
7	29.03.2016	Diskutim	Fondi për Veriun
8	27.04.2016	Rend Dite	Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës
9	23.11.2016	Diskutim	Fondi për Veriun; I ftuar: Ministri i Financave z. Avdullah Hoti

6 mbledhje të tij, i themeluar në bazë të Marrëveshjes së Brukselit të datës 17 janar 2017 mbi Mbledhjen e të Hyrave Doganore.²⁹ Sipas marrëveshjes, të hyrat e grumbulluara në ZPKD-të (pikë kalimet doganore në zonën e përbashkët të MIK-Menaxhim i Integruar i Kufinjëve) në Jarinjë/Rudnica dhe Tabavije/Bërnjak do të transferohen në llogarinë e Fondit të krijuar në një bankë komerciale në Prishtinë të caktuar nga BE. Me qëllim për të promovuar zhvillimin social-ekonomik dhe për të mirën e popullsisë lokale në Leposaviq, në veri të Mitrovicës, Zubin Potok dhe Zvečan.³⁰

Fondi për veriun ka qenë një ndër çështjet më të diskutuara në këtë Komision. Diskutime që kishin të bënin me aspektin ligjor të themelimit të këtij fondi, sa është ky fond dhe në çfarë investohet me këto fonde.

Në shqyrtimin e projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, pjesë e të cilit ishte edhe neni që rregullon funksionimin e këtij fondit të zhvillimit për veriun, anëtarët e komisionit shprehën shqetësimin e tyre lidhur me përputhshmërinë e këtij neni me legjislacionin në fuqi dhe dhënien e fuqisë ekzekutive përfaqësuesit të BE-së në krijimin e këtij fondi. Gjatë diskutimit, anëtarët e komisionit kritikuan Qeverinë për mungesë të transparencës ndaj Kuvendit rreth këtij fondi, sa para mblidhen dhe në çfarë projekte shkojnë këto para.³¹

Ministri i Financave z. Avdullah Hoti ishte i ftuar në pesë (5) nga gjashtë (6) mbledhjet në të cilat Komisioni diskutoi rreth Fondit për Zhvillim (për veriun) gjatë periudhës dhjetor 2014- nëntor 2016, ku

dhe propozoi ndryshimet përkatëse për të siguruar që neni i ligjit të buxhetit i cili rregullon funksionimin e këtij fondi të ishte në përputhje me ligjet në fuqi, ndryshime të cilat u miratuan nga Komisioni. Diskutimet të tjera rreth kësaj teme kishin të bënin me modalitetin e shfrytëzimit të mjeteve nga ky fond, me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve në komunat veriore dhe një vizitë e planifikuar e komisionit në këto komuna për të monitoruar shpenzimet e këtij fondi.

Në çështje tjetër e diskutuar nga Komisioni ka qenë shtirja e doganave të Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës e cila u diskutua në mbledhjen e 13 majit 2015. Me këtë rast Komisioni ka pasur të ftuar drejtorin e doganave të Kosovës të asaj kohe z. Lulzim Rafuna i cili kishte deklaruar para anëtarëve të Komisionit se edhe pse dogana e Kosovës ishte duke funksionuar në veri dhe duke inkasuar detyrimet importuese doganore, sfida mbetej funksionalizimi ose vendosja e plotë në atë pjesë.³²

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka diskutuar gjithashtu edhe rreth temave të tjera të ndërlidhura me procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Një nga këto tema ka qenë Projektligji Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës e cila është tema e vetme e dialogut e paraparë me rendin e ditës të Komisionit. Ky projektligj i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 9 qershor 2016, buron nga marrëveshja për shënimet kadastrale e arritur në Bruksel mes Kosovës dhe Serbisë me 2 shtator 2011.³³ Në kuadër të këtij diskutimi, anëtarët e Komisionit kanë folur rreth kostos buxhetore të këtij projektligji duke propozuar ndryshime

29 Marrëveshja e Brukselit mbi Mbledhjen e të Hyrave Doganore 17 janar 2013 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Marreveshja_e_Brukselit_mbi_Mbledhjen_e_te_Hyrave_Doganore_17_Janar_2013.pdf (qasur me 11.08.2017)

30 Shih marrëveshjen për mbledhjen e të hyrave doganore në, http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_17janar2013_bfvh4eHbPr.pdf (qasur me 11.08.2017)

31 Shih procesverbalin e kësaj mbledhjeje në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2014_12_23_14_5681_al.pdf (qasur me 11.08.2017)

32 Shih mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa të datës, 13 maj 2015 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2015_05_13_10_5931_al.pdf (qasur me 11.08.2017)

33 Shih marrëveshjen për shënimet kadastrale në platformën Vota Ime, Moduli Dialogu Kosovë - Serbi në, <http://votaim.org/Public/Dialog> (qasur me 11.08.2017)

relevante. Komisioni ka nxjerrë edhe një rekomandim përmes të cilit ka konkluduar se ky projektligj përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.³⁴

Komisioni në mbledhjen e 20 majit 2015 diskutoi edhe rreth çështjes së policave të sigurimit të automjeteve dhe kartonit të gjelbër për Kosovën.³⁵ Gjatë këtij diskutimi anëtarët e Komisionit kanë pasur të ftuar guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) z. Bedri Hamza nga i cili kishin kërkuar që të shtoheshin përpjekjet për anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjelbërt si dhe të bëhej ulja e tarifave kufitare të sigurimit. Në anën tjetër guvernatori Hamza kishte deklaruar se ishin ndërmarrë hapa nga BQK për t'u adresuar këto çështje. Ai po ashtu kishte përmendur memorandumun e mirëkuptimit mes Kosovës dhe Serbisë për çështjet e sigurimit të automjeteve³⁶, të cilën e kishte cilësuar si pozitive pasi që mundësonte lirimin e qytetarëve të dy shteteve pa pengesa dhe pa nevojën që të paguajnë polica kufitare. Ky memorandum ishte arritur në Bruksel mes Kosovës dhe Serbisë me 23 qershor 2015.³⁷

4.2 Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Gjatë Legjislaturës së Pestë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka mbajtur gjithsej 69 mbledhje. Çështjet që ndërlidhen me dialogun Kosovë – Serbi janë diskutuar në katër (4) mbledhje të këtij Komisioni, në dy (2) prej të cilave këto çështje kanë qenë të parapara edhe me rendin e ditës (Shih Tabelën 4).

Tema kryesore e diskutuar në këtë komision e ndërlidhur me dialogun ka qenë Marrëveshja e Drejtësisë e cila u trajtua në mbledhjen e 20 prillit 2015.³⁸ Në kuadër të këtij diskutimi, anëtarët e Komisionit ftuan në raportim Ministrin e Drejtësisë z. Hajredin Kuçi për të raportuar për strukturën e gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin gjyqësor në bazë të dialogut, por i njëjti nuk erdhi në raportim.

TABELA 4: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR TË DREJTAT DHE INTERESAT E KOMUNITETEVE DHE KTHIM

Mbledhja	Data	Rend dite/Diskutim	Çështja e Diskutimit
1	09.03.2015	Diskutim	Përzgjedhja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në kuadër të marrëveshjes së drejtësisë
2	20.04.2015	Rend Dite	Raportimi i ministrit të Drejtësisë z. Hajredin Kuçi për strukturën e gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin gjyqësor në bazë të dialogut
3	06.04.2016	Diskutim	Rregullorja rreth lëshimit të certifikatave si zëvendësim për të diplomuarit nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut
4	08.06.2016	Rend Dite	Shqyrtimi i Projekt ligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës

34 Me anë të këtij rekomandimi Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka propozuar këto amendamente në Projektligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës: Amendamenti 1 Neni 27, ndryshohet si vijon: Neni 27 Buxheti i Agjencisë Agjencia përgatit dhe menaxhon buxhetin në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. 3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacionin, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, për Projektligjin Nr. 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Shih procesverbalin e mbledhjes së datës 27.04.2017 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2016_04_27_11_6427_al.pdf (qasur me 10.08.2017)

35 Shih procesverbalin e kësaj mbledhjeje në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2015_05_20_10_5947_al.pdf (qasur me 10.08.2017)

36 Shih këtë marrëveshje në, http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/MemorandumiiMirekuptimit_23qershor2015_2MXFqivUKj.pdf (qasur me 10.08.2017)

37 Shih tekstin e këtij memorandumit në, http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/MemorandumiiMirekuptimit_23qershor2015_2MXFqivUKj.pdf (qasur me 10.08.2017)

38 Marrëveshja e Drejtësisë e arritur në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian mbulohet nga 4 marrëveshje/dakordimi të arritura në kuadër të këtij procesi. Herën e parë parimet mbi të cilat palët janë dakorduar për integrimin e sektorit të drejtësisë janë përfshirë në Marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve më 19 prill 2013 si dhe në planin e zbatimit 21 maj 2013 të ratifikuar në Kuvend e Republikës së Kosovës, më pas në marrëveshjen për drejtësi të arritur më 9 shkurt 2015 si dhe në konkluzat e BE-së për drejtësi të arritura më 30 nëntor 2016.

Në vend të tij ai kishte dërguar Zëvendësministrin e Drejtësisë z. Lirak Çelaj i cili para anëtarëve të Komisionit kishte deklaruar se Marrëveshja e Drejtësisë parasheh zbatimin e plotë të legjislativës së Republikës së Kosovës dhe funksionimin e sistemi unik të drejtësisë, në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ai kishte shtuar se në kuadër të kësaj marrëveshjeje, themelimi i Gjykatës Themelore dhe zyrës së Prokurorisë Themelore në shtatë (7) komunat e rajonit të Mitrovicës, ishte në përputhje të plotë me ligjin për Gjykatat. Me këtë rast, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, kishin marr hapa konkret në plotësimin e vendeve të punës, si për gjyqtarë dhe prokurorë ashtu edhe për stafin mbështetës, nga radhët e komuniteteve jo shumicë.³⁹

Në anën tjetër, anëtarët e Komisionit kishin shprehur shqetësimin e tyre lidhur me këtë proces dhe ishin të mendimit se marrëveshja për drejtësinë ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventave për të Drejtat e Njeriut të inkorporuara në Kushtetutë. Sipas tyre kjo për arsye se gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar ishin vetëm shqiptar dhe serb dhe jo nga komunitetet tjera jo-shumicë. Lidhur me këtë Zëvendësministri kishte sqaruar para Komisionit se disa vende në strukturat gjyqësore dhe prokuroriale në veri të Mitrovicës kishin mbetur të paplotësuara dhe nuk e kishte përjashtuar mundësinë që në ardhmen të aplikojnë edhe përfaqësuesit e komuniteteve tjera jo shumicë.⁴⁰

Tema tjetër me rëndësi e diskutuar në këtë Komision rreth dialogut ka qenë Projektligji nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës, ku vëmendje e veçantë i ishte kushtuar pjesës me të cilën rregulloheshin pronat private, komerciale dhe të bashkësive fetare.⁴¹ Në këtë mbledhje ishte ftuar edhe Koordinatorin i Zyrës ligjore pranë Zyrës të Kryeministrit z. Jeton Oruçi për të sqaruar përmbajtjen e projektligjit në fjalë. Gjatë këtij diskutimi anëtarët e Komisionit kishin shprehur shqetësimin e tyre lidhur me atë se asnjë pjesëtarë i komunitetit serb dhe as komuniteteve tjera jo shumicë, nuk kishin qenë të përfshirë në grupin punues për hartimin e këtij projektligji, duke ua mohuar atyre të drejtën për të mbrojtur interesat e komuniteteve. Ndërsa përgjigjja e koordinatorsit të Zyrës ligjore pranë Zyrës të Kryeministrit ishte se të gjitha palët e interesuara kishin qenë të ftuara në procesin e hartimit të këtij projektligji.



Shikuar në përqindje, Ministrat e qeverisë kanë raportuar ekskluzivisht për dialogun në 6% të mbledhjeve të Komisioneve, ndërsa në 19% të mbledhjeve ku ata kanë qenë të ftuar janë ngritur çështjet e ndërlidhura me dialogun Kosovë-Serbi.

Sa i përket çështjes së pronave private, koordinatori Oruçi kishte deklaruar se ky ligj kishte të bënte me zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pasurinë e paluajtshme në pronësi private, pasurinë bujqësore, dhe pronën komerciale si pasuri private e komunitetit fetar. Përmes këtij ligji do të bëhej krahasimi dhe zgjidhja e dallimeve ndërmjet dokumenteve origjinale kadastrale të marra nga Serbia para qershorit të vitit 1999 dhe dokumentacionit aktual kadastral në Republikën e Kosovës.⁴² Në fund të diskutimit Komisioni kishte marrë vendim që të mos mbështeste këtë projektligj në procedimin e mëtejshëm dhe miratimin e tij. Ky projektligj nuk u diskutua më në mbledhjet pasuese të këtij komisioni.

Tema e fundit e ndërlidhur me dialogun që ishte diskutuar në këtë komision gjatë legjislaturës së pestë ishte çështja e zbatimit të Rregullores rreth lëshimit të certifikatave si zëvendësim për të diplomuarit nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, e miratuar nga qeveria e Kosovës në janar 2016.⁴³ Ky dokument buronte nga Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave e cila u arrit mes Kosovës dhe Serbisë, më 2 korrik 2011. Çështja e zbatimit të kësaj rregulloreje ishte ngritur në mbledhjen e 6 prillit 2016, ku komisioni kishte ftuar drejtorin e Zyrës për Komunitete z. Ivan Tomić.⁴⁴ Sipas z. Tomić, krahas problemeve të shumta dhe pengesave në këtë proces, rregullorja e aprovuar ishte pozitive por duhej të pritej nëse do të zbatohet në praktikë. Megjithatë, sipas tij do të ishte ideale që kjo çështje të zgjidhej në mënyrë permanente në nivel më të lartë, pasi që rregullorja ishte vetëm masë e përkohshme derisa sa Kosova dhe Serbia të arrinin një marrëveshje në këtë drejtim.⁴⁵

39 Shih procesverbalin e kësaj mbledhjeje në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2015_04_20_13_5898_al.pdf (qasur me 11.08.2017)

40 Po aty.

41 Shih procesverbalin e kësaj mbledhjeje në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2016_06_08_11_6501_al.pdf (qasur me 12.08.2017)

42 Po aty.

43 Shih këtë Rregullore në, http://kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_QRK_-_NR_21-2015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTET-ASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf (qasur me 12.08.2017)

44 Shih procesverbalin e kësaj mbledhjeje në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2016_04_06_13_6394_al.pdf (qasur me 12.08.2017)

45 Vlen të theksohet se Qeveria e Kosovës kishte miratuar këtë Rregullore për arsye të kontestit të juridiksionit mes Kosovës dhe Serbisë për këtë universitet. Sipas Qeverisë ky mekanizëm ligjor do të ishte masë e përkohshme afirmative, me qëllim avancimin e ri integritetit të serbëve në sistemin e Kosovës.

4.3 Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, gjatë legjislativës së

pestë ka mbajtur gjithsej 108 mbledhje.⁴⁶ Çështja e procesit të dialogut Kosovë - Serbi është diskutuar në 16 nga mbledhjet e Komisionit, në shtatë (7) prej të cilave ka qenë e përcaktuar edhe me rendin e ditës (Shih Tabelën 5). Diskutimet rreth dialogut në këtë Komision janë karakterizuar me debate të ashpra dhe mospajtime sidomos në rastet kur kanë raportuar përfaqësues të qeverisë.

Dy çështjet më të debatuar në këtë Komision të ndërlidhura me dialogun kanë qenë Projektligji për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës, temë të cilën Komisioni e ka pasur si pikë të rendit të ditës në pesë (5) takime të tij dhe Marrëveshja për Drejtësi.

TABELA 5: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR LEGJISLACION, MANDATE, IMUNITETE, RREGULLOREN E KUVENDIT DHE MBIKQYRJEN E AGJENCISË KUNDËR KORRUPCIONIT

Mbledhja	Data	Rend dite/Diskutim	Çështja e Diskutimit
1	02.03.2015	Diskutim	Marrëveshja Parë e Parimeve që rregullon Normalizimin e Marrëdhënieve
2	24.03.2015	Rend Dite	Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës
3	21.04.2015	Diskutim	Veprimi I Agjencisë Kundër Korrupsion në rastin e emërimit të koordinatorit të bisedimeve me Serbinë
4	13.05.2015	Rend Dite	Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
5	16.06.2015	Diskutim	Njohja reciproke e diplomave
6	29.06.2015	Diskutim	Çështja e përfshirjes së shtetasve të Serbisë në listën e votuesve në zgjedhjet 2014
7	01.07.2015	Rend Dite	Shqyrtimi i Projektligjit për agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës. E ftuar Ministria për Dialog znj. Edita Tahiri
8	10.09.2015	Diskutim	Marrëveshjet e arritura në Bruksel në gusht 2015
9	16.09.2015	Diskutim	Ftesë znj. Edita Tahiri që të vijë në mbledhjen e Komisionit për të raportuar lidhur me bazën kushtetuese dhe ligjore të marrëveshjeve arritura me Serbinë
10	19.04.2016	Rend Dite	Shqyrtimin e raportit me amendamente në Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
11	10.05.2016	Rend Dite	Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
12	20.06.2016	Diskutim	Mbajtja e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë
13	28.06.2016	Diskutim	Marrëveshja për Drejtësi
14	26.10.2016	Diskutim	Marrëveshja për drejtësinë; Arrestimi i Nehat Taçit; E ftuar: Ministria e Drejtësisë znj. Dhurata Hoxha
15	29.11.2016	Rend Dite	Prezantimi i projektit për monitorimin e procesit të dialogut Kosovë - Serbi, nga përfaqësuesit e KDI-se
16	22.02.2017	Rend Dite	Dëgjim publik në lidhje me zbatimin e marrëveshjes për Drejtësinë - E ftuar: Ministria e Drejtësisë znj. Dhurata Hoxha dhe Ministria për dialog znj. Edita Tahiri

46 Për një (1) prej këtyre mbledhje të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit nuk ka pasur lajme në ueb faqen e Kuvendit se është mbajtur edhe pse ajo ka qenë e planifikuara sipas kalendarit. Numri i mbledhjeve i paraqitur nga KDI është sipas kalendarit të takimeve në ueb faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës.

Gjatë diskutimeve për Projektligjin për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës, anëtarët e Komisionit kanë paraqitur shqetësimet e tyre rreth kushtetutshmërisë së këtij projektligji, përbërjen dhe funksionimin e agjencisë, periudhën e operimit të saj si dhe financimin dhe mbikëqyrjen e saj nga institucionet e Kosovës. Përveç shqetësimeve të ngritura ky ligj ishte vlerësuar pozitivisht për faktin se miratimi i tij mundësonte sqarimin e kon testeve pronësore në Kosovë.⁴⁷

Para procedimit të këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës anëtarët e Komisionit kishin propozuar edhe amendamente lidhur me çështjet e lartpërmendura.⁴⁸ Gjithashtu, për të mësuar më tepër rreth këtij projektligji, Komisioni në një nga mbledhjet e tij ka pasur të ftuar në raportim Ministren për Dialog znj. Edita Tahiri, e cila ka folur rreth qëllimit dhe përbajtjes së projektligjit në fjalë si dhe rolin e Agjencisë. Ministria Tahiri kishte deklaruar se ky projektligj buronte nga Marrëveshja për Kadastër dhe ishte bërë obligim ndërkombëtar për Kosovën, rikujtim ky duke konsideruar që Kuvendi i Kosovës po e shtynte miratimin e tij. Ministria Tahiri i kishte informuar anëtarët e Komisionit se në përputhje me kërkesën e tyre, udhëheqësi i kësaj Agjencie që parashihej të ishte ndërkombëtar tani do të ishte vendor. Në mbledhjen e 10 majit 2016, ky Komision pati për herë të fundit si pikë të rendit të ditës këtë çështje, në të cilin i rekomandoi Kuvendit që të miratojë këtë projektligj me amendamentet shtesë lidhur me buxhetin e kësaj Agjencie.

Tema tjetër të cilën ky Komision e ka diskutuar ishte Marrëveshja e Drejtësisë e cila është diskutuar në tri (3) mbledhje të këtij Komisioni. Kjo çështje ishte e paraparë me rendin e ditës vetëm një herë kur Komisioni organizoi një dëgjim publik në të cilin kishte ftuar Ministren e Drejtësisë znj. Dhurata Hoxha dhe Ministren për Dialog znj. Edita Tahiri për të raportuar rreth kësaj marrëveshjeje.⁴⁹

Në këtë takim, Ministria Tahiri deklaroi se Marrëveshja për Drejtësi e vendoste sistemin unitar të drejtësisë në tërë territorin e Kosovës. Gjithashtu ajo theksoi se kjo marrëveshje pritej të zbatohet më 10 janar 2017, duke cilësuar shkaktar për vonesat në zbatimin provokimet e bëra nga shteti i Serbisë në veri të Mitrovicës, si ndërtimi i murit dhe tentimi për futjen e trenit ilegal në Kosovë.⁵⁰ Ndërsa, Ministria e Drejtësisë znj. Hoxha pasi raportoi rreth rolit të kufizuar të Ministrisë në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, rikonfirmoi angazhimin e Ministrisë në ofrimin e kushteve sa më të mira për integrimin e komunitetit serb në sistemin e drejtësisë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislatonin në fuqi.⁵¹

Anëtarët e Komisionit ngritën shqetësimin për kushtetutshmërinë e kësaj marrëveshjeje dhe efektet që do të ketë në sistemin unik të drejtësisë në gjithë territorin e Kosovës, duke theksuar mungesën e transparencës lidhur me Marrëveshjen për Drejtësi. Disa nga pyetjet e shtruarat për dy Ministret kishin të bëjnë me çështjen e kritereve të përcaktuara për integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë dhe kohën e betimit të tyre. Po ashtu, anëtarët e Komisionit kërkuar garancione nga ministria Tahiri, se ky proces do të jetë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës.

Ky Komision ka diskutuar gjithashtu edhe rreth një sërë çështjesh që ndërlidhen me dialogun si marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave, mbajtja e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, arrestimi i zëvendës komandantit të policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës së Jugut z. Nehat Thaçi si dhe tema tjera siç janë Marrëveshja e Parë e Parimeve për Normalizimin e Marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë, Marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe, të cilat janë përmendur në terma të përgjithshëm në kuadër të diskutimeve të takimeve të mbajtura të Komisionit.

Ky Komisioni kishte pasur në rend dite në një nga mbledhjet e mbajtura edhe prezantimin e përfaqësuesve të KDI-së të projektit "Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi". Në këtë takim anëtarët e Komisionit kishin shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar për të rritur transparencën dhe komunikimin me qytetarët për çështjen e dialogut.

4.4 Komisioni për Integritim Evropiane

Përgjatë Legjislaturës së Pestë, Komisioni për Integritim Evropiane i Kuvendit të Kosovës, ka mbajtur gjithsej 71 mbledhje⁵² në të cilat ka diskutuar për temat që bien në fushëveprimin e këtij Komisioni sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës. Komisioni për Integritim Evropiane është ndër komisionet që ka diskutuar më së shumti rreth dialogut Kosovë-Serbi duke diskutuar rreth çështjeve që ndërlidhen me këtë proces në 19 mbledhje të tij, përfshirë këtu dy (2) herë si pjesë të rendit të ditës (Shih Tabelën 6).

47 Shih procesverbalet e mbledhjes së datës 24 mars 2015, 1 korrik 2015, 19 prill 2016 dhe 10 maj 2016 në, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1.159> (qasur me 12.08.2017)

48 Shih amendamentet në këtë projektligj në mbledhjen e datës 19 prill 2016 të Komisionit në, http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/proc_2016_04_19_10_6414_al_H9CMnHvrbV.pdf (qasur me 12.08.2017)

49 Ky dëgjim publik ishte organizuar me asistencën e KDI-së e cila kishte përgatitur edhe një pako informuese për anëtarët e këtij komisioni, në të cilën kishte ofruar një analizë të marrëveshjes për drejtësi, gjendjes së zbatimit të saj në terren si dhe çështjet tjera që mbeteshin për tu adresuar lidhur me këtë marrëveshje.

50 Shih lajmin rreth kësaj mbledhje në ueb faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës në, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1.128.8713> (qasur me 12.08.2017)

51 Po aty.

52 Për shtatë (7) prej këtyre mbledhjeve të Komisionit për Integritim Evropiane nuk ka pasur lajme në uebfaqen e Kuvendit se janë mbajtur edhe pse ato kanë qenë të planifikuara sipas kalendarit. Numri i mbledhjeve i paraqitur nga KDI është sipas kalendarit të takimeve në ueb faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës.

TABELA 6: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR INTEGRIME EVROPIANE

Mbledhja	Data	Rend dite/ Diskutim	Çështja e Diskutimit
1	24.12.2014	Diskutim	Ideja për t' a ftuar kryeministrin në Komision që të flasë për lidhshmërinë në mes të dialogut me Serbinë dhe perspektivën evropiane të Kosovës
2	02.03.2015	Diskutim	Migrimi ilegal duke shfrytëzuar marrëveshjen për lëvizjen e lirë: I ftuar: Ministri i Punëve të Brendshme z.Skender Hyseni
3	06.03.2015	Diskutim	Roli i BE-së në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit; Marrëveshja për Drejtësi
4	21.04.2015	Diskutim	Lëvizja e lirë e mallrave të Kosovës në Serbi; E ftuar: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë znj. Hikmete Bajrami
5	27.04.2015	Diskutim	Marrëveshja e parë e parimeve për normalizim të marrëdhënieve; Marrëveshja për Drejtësi; I ftuar: Ministri i Drejtësisë, z.Hajredin Kuçi
6	12.05.2015	Diskutim	Marrëveshja e parë e parimeve për normalizim të marrëdhënieve; Strukturat paralele dhe integrimi; I ftuar: Ministri i Administratës Publike, z.Mahir Yagcilar
7	15.06.2015	Diskutim	Pjesëmarrja e Komisioneve në dialog me Serbinë
8	18.09.2015	Diskutim	Procesi I Dialogut në përgjithësi, në kuadër të vizitës së delegacionit të senatorëve italianë
9	03.11.2015	Diskutim	Marrëveshja për Asociacionin e Komunave Serbe; I ftuar: Ministri i Integritimit Evropian z.Bekim Collaku
10	25.01.2016	Diskutim	Procesi i Dialogut në përgjithësi; I ftuar: Ministri i Integritimit Evropian z.Bekim Collaku
11	02.02.2016	Diskutim	Komunikatat e BE-së rreth takimeve të Dialogut
12	26.04.2016	Rend Dite	Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës
13	04.07.2016	Diskutim	Marrëveshja për Asociacionin e Komunave Serbe; I ftuar: Ministri i Drejtësisë, z.Hajredin Kuçi
14	05.10.2016	Diskutim	Dialogu dhe zbatimi i marrëveshjeve
15	18.10.2016	Rend Dite	Prezantim i projektit për monitorimin e procesit të dialogut Kosovë - Serbi, nga përfaqësuesit e KDI-se; Menaxhimi i Integruar i kufirit me Serbinë; Arrestimi i Nehat Thaçit. I ftuar: Ministri i Punëve të Brendshme, z.Skender Hyseni.
16	31.10.2016	Diskutim	Marrëveshja për telekomunikacionin. I ftuar: Ministri për Zhvillim Ekonomik, z.Blerand Stavileci
17	15.11.2016	Diskutim	Dialogu në kuadër të marrëveshjes financiare për IPA 2015
18	14.12.2016	Diskutim	Transparenca e procesit të dialogut; Muri në Urën e Mitrovicës; Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë
19	24.01.2017	Diskutim	Arrestimi i Ramush Haradinaj dhe Nehat Thaçit; Ndërtimi i murit; Treni me simbolet serbe.

Në nëntë (9) nga 19 mbledhjet ku është diskutuar rreth dialogut Kosovë-Serbi prezent ishin Ministrat e Qeverisë, duke e bërë këtë Komision me prezencën më të lartë të Ministrave në mbledhjet ku është ngritur tema e dialogut. Megjithatë asnjëri nga Ministrat nuk është ftuar për të raportuar për dialogun në këtë komision, çështjet rreth dialogut janë ngritur vetëm në kuadër të diskutimeve të tjera për të cilat ata janë ftuar në komision.

Vlen të theksohet se ky Komision kishte filluar diskutimet rreth procesit të dialogut qysh në mbledhjen e parë konstituive të Komisionit të mbajtur me 24 dhjetor 2014.⁵³ Çështja e diskutuar ishte ideja për të ftuar në Komision, Kryeministrin e vendit për të diskutuar rreth lidhshmërisë në mes të dialogut Kosovë - Serbi dhe perspektivës

evropiane të Kosovës. Plan ky i cili nuk ishte realizuar gjatë legjislaturës së pestë.

Diskutimet kryesore rreth dialogut në këtë Komision janë zhvilluar gjatë periudhës tetor 2016 – janar 2017 e cila ndërlidhet me një sërë ngjarje të ndërlidhura me dialogun, pas ndërtimit të murit në Urën e Mitrovicës, arrestimit të kolonelit të Policisë së Kosovës z. Nehat Thaçi, ndalimit të kryetarit të AAK-së z. Ramush Haradinaj dhe tentimit të Serbisë për futjen e trenit me simbole provokative në Kosovë.

Gjatë këtyre diskutimeve anëtarët e komisionit shprehën shqetësimet e tyre lidhur me qasjen destruktive të Serbisë karshi Kosovës

53 Shih procesverbalin e kësaj mbledhje në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2014_12_24_11_5682_al.pdf (qasur me 12.08.2017)

dhe rolin e qeverisë së Kosovës në procesin e dialogut në Bruksel. Ata po ashtu kishin kritika ndaj qeverisë për mos transparencë rreth procesit të dialogut në përgjithësi dhe kërkuan përfshirje më të madhe të Komisionit dhe Kuvendit në këtë proces.⁵⁴

Një ndër çështjet e ngritura nga ky Komision ishte roli i BE-së në këtë proces dhe në garantimin e zbatimit të marrëveshjeve të dala nga dialogu. Në tri (3) mbledhje ku ka diskutuar mbi këtë çështje, Komisioni ka ftuar edhe shefat e zyrës së BE-së në Kosovë z. Samuel Žbogar dhe pasardhësja e tij znj. Nataliya Apostolova rreth rrugës së Kosovës drejt integritimit në Bashkimin Evropian dhe raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, ku është diskutuar edhe rreth çështjes së dialogut.⁵⁵

Komisioni për Integritim Evropian gjatë legjislaturës së pestë ka diskutuar edhe mbi marrëveshjen e parë të parimeve, marrëveshja për asociacionin, marrëveshja për drejtësinë, lëvizja e lirë, IBM-i telekomunikacioni, projektligji për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim

të pronës dhe prezantim i projektit për monitorimin e procesit të dialogut Kosove - Serbi, nga përfaqësuesit e KDI-se. Dy temat e fundit ishin dy (2) nga çështjet e vetme të cilat kanë qenë të përcaktuara paraprakisht me rendin e ditës në mbledhjet e këtij komisioni.

4.5 Komisioni për Punë të Jashtme

Gjatë legjislaturës së pestë të Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Punë të Jashtme, ka mbajtur gjithsej 45 mbledhje.⁵⁶ Çështjet që ndërlidhen me procesin e dialogut Kosovë - Serbi janë diskutuar në 16 mbledhje të këtij Komisioni, ku në 6 (gjashtë) prej tyre ato kanë qenë të përcaktuara paraprakisht me rendin e ditës të komisionit (Shih Tabelën 7).

TABELA 7: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR PUNË TË JASHTME

Mbledhja	Data	Rend dite/ Diskutim	Çështja e Diskutimit
1	21.01.2015	Diskutim	Të parashihet raportimi i ministres për dialog në Komision
2	18.03.2015	Rend Dite	Raportim i ministres për Dialog, znj. Edita Tahiri për procesin e dialogut në përgjithësi
3	13.07.2015	Diskutim	Përcaktimi i kufirit me Serbinë
4	21.01.2016	Diskutim	Diskutim mbi dialogun në kuadër të vizitës së delegacionit të Grupit të Miqësisë nga Parlamenti i Austrisë
5	16.02.2016	Diskutim	Dialogu dhe qasja e Serbisë ndaj Kosovës
6	04.04.2016	Diskutim	Zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit në kuadër të vizitës së parlamentarëve Gjerman
7	20.09.2016	Rend Dite	Prezantim i projektit për monitorimin e procesit të dialogut Kosove - Serbi, nga përfaqësuesit e KDI-së
8	04.10.2016	Diskutim	Ftesë për raportim ministres për dialog; Arrestimi i Nehat Thaçit
9	05.10.2016	Diskutim	Arrestimi i Nehat Thaçit; Fushata e Serbisë kundër Kosovës; I ftuar: Ministri i Punëve të Jashtme z.Enver Hoxhaj
10	07.10.2016	Diskutim	Obstruksionet e Serbisë kundër Kosovës
11	26.10.2016	Rend Dite	Raportim i Ministres për Dialog, znj.Edita Tahiri
12	12.12.2016	Rend Dite	Situata në Mitrovicë pas ndërtimit të murit
13	18.01.2017	Rend Dite	"Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor"
14	25.01.2017	Diskutim	Aktivitetet rreth monitorimit të dialogut në Planin e Punës së Komisionit; Transparenca e Qeverisë rreth Dialogut.
15	08.02.2017	Rend Dite	Raportim i Ministres për Dialog, znj. Edita Tahiri
16	08.02.2017	Rend Dite	Raportim i Ministrisë të Punëve të Jashtme, z.Enver Hoxhaj, lidhur me raportet Kosovë - Serbi

⁵⁴ Shih procesverbalin e mbledhjes së datës 24 janar 2017 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2017_01_24_11_6810_al.pdf

⁵⁵ Shih proces verbalin e mbledhjeve të datës 6 mars 2015, 5 tetor 2016 dhe 14 dhjetor 2016 në, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1.159>

⁵⁶ Për një (1) prej këtyre mbledhjeve të Komisionit për Punë të Jashtme nuk ka pasur lajm në uebfaqen e Kuvendit se është mbajtur edhe pse ajo ka qenë e planifikuar sipas kalendarit. Numri i mbledhjeve i paraqitur nga KDI është sipas kalendarit të takimeve në uebfaqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës.

Roli i Komisionit për Punë të Jashtme në procesin e dialogut Kosovë - Serbi ishte përcaktuar shprehimisht në Rezolutën e miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 10 mars 2011. Pika e gjashtë (6) e kësaj rezolute thotë se: "I/e emëruari nga Kryeministri udhëheqës i delegacionit të Republikës së Kosovës për dialogun me Republikën e Serbisë do të informojë në baza të rregullta Komisionin për Politikë të Jashtme dhe komisionet tjera përkatëse të Kuvendit të Kosovës dhe do të raportoj, edhe në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës."⁵⁷

Ministrja për Dialog znj. Edita Tahiri ka raportuar tri (3) herë para këtij Komisioni për procesin e dialogut Kosovë - Serbi në përgjithësi dhe zbatimin e marrëveshjeve të dala nga ky proces. Gjatë këtyre raportimeve ministrja Tahiri përmendi rezultatet e arritura nga dialogu, që kanë mundësuar forcimin e sovranitetit të shtetit të Kosovës, në shtrirjen e sovranitetit në veri si dhe në integrimin e serbëve në sistemin shtetëror të Kosovës. Ajo po ashtu kishte deklaruar se dialogu i Brukselit kishte afruar Kosovën me Bashkimin Evropian dhe NATO-n dhe ishte arritur nënshkrimi i MSA-së.⁵⁸



Ministrja Tahiri kishte dorëzuar zyrtarisht për anëtarët e Komisionit temat që priteshin të diskutoheshin në të ardhmen në dialog si demarkacioni shtetëror mes kufirit të Kosovës e Serbisë, ndërprerja e ndërhyrjes së Serbisë në Kosovë në fushat tjera që nuk janë trajtuar në marrëveshjet e Brukselit, reparacionet, çështja e të pagjeturve, vendosja e bashkëpunimit ndërshtetëror në fushat e interesit të ndërsjellë, garancitë, satisfaksioni dhe suksesioni.⁵⁹

Gjatë këtyre diskutimeve ka pasur përplasje verbale mes Ministres dhe deputetëve kryesisht të partive opozitare të cilët kanë kërkuar përgjegjësi nga ministrja Tahiri lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel dhe kushtetutshmërinë e tyre. Ata janë shprehur të pakënaqur me rezultatet që ka sjellë dialogu Kosovë - Serbi në shtrirjen e sovranitetit në tërë territorin, shuarjen e strukturave paralele, integrimin e komunitetit serb në institucionet e Kosovës, anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare etj.

Përveç Ministres Tahiri në këtë Komision kishte raportuar një (1) herë rreth raporteve me Serbinë edhe Ministri i Punëve të Jashtme z. Enver Hoxhaj. Ai gjatë këtij diskutimi kishte kritikuar qasjen e Serbisë ndaj Kosovës me rastin e ndërtimit të murit mbi Urën e Mitrovicës, arrestimin e Nehat Thaçit dhe ndalimin e z. Ramush Haradinaj në Francë me urdhër arrest të shtetit të Serbisë. Ai kishte deklaruar para anëtarëve të Komisionit se institucionet e Kosovës kishin ndërmarrë masat e nevojshme për të adresuar këto probleme. Në anën tjetër anëtarët e Komisionit kishin ngritur çështjen e ndalimit të z. Haradinaj, dhe kishin kërkuar nga Ministri Hoxhaj që t'i informonte ata lidhur me zhvillimet rreth këtij rasti, si dhe për strategjinë e Qeverisë ndaj veprimeve destruktive të Serbisë gjatë muajve të fundit.⁶⁰

Një ndër temat qendrore rreth dialogut për të cilat ky Komision ka diskutuar ka qenë situata në Mitrovicë pas ndërtimit të murit.⁶¹ Në këtë mbledhje Komisioni ka pasur vetëm këtë çështje pjesë të rendit të ditës për diskutim gjatë së cilës anëtarët e komisionit kanë shprehur shqetësimin e tyre se ndërtimi i këtij muri po ndante Mitrovicën dhe shtetin e Kosovës.⁶² Gjatë këtij diskutimi, anëtarët e Komisionit kërkuar që Qeveria të ishte transparente ndaj Kuvendit dhe Komisionit rreth kësaj çështjeje dhe procesit të dialogut në përgjithësi. Disa nga anëtarët propozuan edhe ndërprerjen e bisedimeve me Serbinë për shkak të veprimeve të saj ndaj Kosovës. Kjo gjë ndodhi me 9 mars 2017 kur Kuvendi miratoi rezolutën në një nga pikat e së cilës kërkonte që dialogu të pezullohej deri në lirimin e z. Ramush Haradinaj.⁶³

Më 2 dhjetor 2016, anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme në bashkëpunim me KDI-në, kishin vizituar Mitrovicën, për të parë nga afër zbatimin e marrëveshjes së Brukselit për rivalizimin e urës së Mitrovicës, ku kishin bërë monitorimin e punimeve në urën mbi lumin Ibër. Në këtë periudhë ende nuk kishte filluar ndërtimi i murit mbi Urën e Ibrit dhe anëtarët e Komisionit kishin konsideruar se punët po zhvilloheshin pa asnjë problem dhe se ura e cila ishte konsideruar si urë e ndarjes, tashmë ishte duke u bërë urë e komunikimit. Megjithatë, muri mbi urën e Mitrovicës filloi të ndërtohej vetëm disa ditë pas kësaj vizite të Komisionit. Kjo është vizita e parë e zhvilluar në terren nga një Komision parlamentar për të monitoruar zbatimin e marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi.

Tema tjera rreth dialogut për të cilat Komisioni për Punë të Jashtme ka diskutuar gjatë legjislaturës së pestë kanë qenë edhe arrestimi i kolonelit të Policisë z. Nehat Thaçi, përcaktimi i kufirit me Serbinë, shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, monitorimi i procesit të dialogut nga Komisioni etj.

57 Shih Rezolutën "Për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 10 mars 2011 në, <http://votaim.org/Public/DraftLaes#resolutions> (qasur me 13.08.2017)

58 Shih procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të datës 18 mars 2015 dhe 26 tetor 2016 dhe 8 shkurt 2017 në, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,159> (qasur me 13.08.2017)

59 Shih procesverbalin e kësaj mbledhjeje në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2016_10_26_13_6687_al.pdf (qasur me 13.08.2017)

60 Shih procesverbalin e mbledhjes së datës 8 shkurt 2017 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2017_02_08_14_6847_al.pdf (qasur me 13.08.2017)

61 Ky diskutim i Komisionit ishte realizuar me 12 dhjetor 2016, në konsultim me KDI-në në kuadër të projektit për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi si dhe fuqizimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj Qeverisë.

62 Shih procesverbalin e mbledhjes së datës 12 dhjetor 2016 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2016_12_12_10_6759_al.pdf (qasur me 13.08.2017)

63 Shih këtë rezolutë në, http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/2017_03_09_Rezoluta_nr_011_per_lirimin_e_Ramush_Haradinaj_dth3C6E93D.pdf (qasur me 13.08.2017)

4.6 Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Komisioni për Arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport gjatë legjislaturës së pestë ka mbajtur gjithësej 82 mbledhje. Nga numri total i mbledhjeve të mbajtura, ky Komision asnjëherë nuk ka pasur si pikë të rendit të ditës ndonjë çështje të ndërlidhur me procesin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, mirëpo në 10 takime është diskutuar për çështje të ndërlidhura me dialogun (Shih Tabelën 8).

Komisioni për Arsim ka diskutuar kryesisht për dy tema: akreditimin e Universitetit të Mitrovicës, që vazhdon të funksionoj jashtë kontrollit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe bllokimin nga ana e Serbisë për librat shkollor që Ministria e Arsimit kishte dërguar për nxënësit shqiptar në Luginën e Preshevës.

Në 10 takimet ku u trajtuan tema të ndërlidhura me dialogun Kosovë – Serbi, dy herë i ftuar ishte edhe Ministri i Arsimit, z.Arsim Bajrami, i cili dha shpjegime rreth librave të dërguar në Preshevë dhe bllokimin e tyre nga ana e doganave serbe. Anëtarët e këtij Komisioni kërkuan zbatim të reciprocitetit me shtetin serb në këtë aspekt, pasi që edhe Serbia vazhdimisht u dërgon libra me planpro-

grame serbe institucioneve edukativo-arsimore serbe që funksionojnë në Kosovë, kryesisht në veri të vendit. Pas kërkesës së ngritur nga deputetët e këtij Komisioni, Ministri Bajrami, në mbledhjen e mbajtur me datën 24 nëntor 2015 deklaroi se do të zbatohet parimi i reciprocitetit në këtë rast.

Sa i përket akreditimit dhe funksionimit të Universitetit të Mitrovicës së Veriut në bazë të ligjeve të Kosovës, kjo çështje u trajtua edhe nga Ministri Bajrami por edhe nga Kryetari i Këshillit Kombëtar për Cilësi, z.Blerim Rexha. Në mbledhjen e mbajtur me datën 11 maj 2016, Komisioni kishte ftuar z.Rexha ku ndër të tjera u diskutua edhe për mundësinë e akreditimit të këtij Univeristeti konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, z.Rexha kishte deklaruar se “kjo është më shumë çështje politike sesa praktike dhe punë e Agjencisë dhe se shpresonte që me dialogun e Brukselit të zgjidhej edhe korniza ligjore dhe Agjencia do të fillojë procesin e njëjtë sikur edhe me institucionet tjera.”⁶⁴

Komisioni nuk e ka vlerësuar si të arsyeshme të ftojë në raportim as Ministrin e Arsimit e as Ministrin për Dialog për të diskutuar rreth marrëveshjeve të arritura mes Kosovës dhe Serbisë lidhur me pranimin e diplomave. Kjo marrëveshje është ndër marrëveshjet e para të arritura mes palëve, dhe në kuadër të saj janë arritur gjithësej katër nën-marrëveshje, që përfshijnë njohjen e diplomave në të gjitha nivelet e studimit, përfshirë këtu studimet e doktoraturës, zbatimi i të cilës ka hasur në probleme dhe ngecje të shumta.

TABELA 8: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI, KULTURË, RINI DHE SPORT

Mbledhja	Data	Rend dite/ Diskutim	Çështja e Diskutuar
1	11.03.2015	Diskutim	Bllokimi i librave
2	18.03.2015	Diskutim	Akreditimi i Uni. Mitrovicë. I ftuar: Arsim Bajrami
3	03.06.2015	Diskutim	Akreditimi i Uni. Mitrovicë
4	23.09.2015	Diskutim	Akreditimi i Uni. Mitrovicë
5	24.11.2015	Diskutim	Bllokimi i librave. Akreditimi i Uni. Mitrovicë. I ftuar: Arsim Bajrami
6	20.01.2016	Diskutim	Akreditimi i Uni. Mitrovicë
7	04.03.2016	Diskutim	Bllokimi i librave
8	15.03.2016	Diskutim	Bllokimi i librave
9	11.05.2016	Diskutim	Akreditimi i Uni. Mitrovicë
10	26.09.2016	Diskutim	Bllokimi i librave

⁶⁴ Procesverbali i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, e mbajtur me 11 maj 2016: http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/proc_2016_05_11_10_6456_al_tmtkXRY86.pdf (qasur me 23.07.2017)



4.7 Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Komisioni për administratë publike, qeverisje lokale dhe media ka realizuar gjithsej 42 mbledhje gjatë legjislaturës së pestë. Përkundër faktit se qeverisja lokale është njëra ndër kompetencat kryesore të këtij Komisioni, dhe Marrëveshja për Themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është e ndërlidhur me këtë komponentë, ky Komision ka përfshirë si rend dite vetëm një herë çështje të ndërlidhura me dialogun mes Kosovës dhe Serbisë (Shih Tabelën 9).

Më 10 tetor 2016, ky Komision ka diskutuar rreth dialogut me Serbinë, konkretisht rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në të cilin kishte ftuar për raportim Ministren e Dialogut znj. Edita Tahiri për të sqaruar kompetencat e AKS-së dhe nëse marrëveshja e Brukselit për themelimin e këtij Asociacioni përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ministrja Tahiri para deputetëve të këtij Komisioni deklaroi se marrëveshja për themelimin e Asociacionit është në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet në fuqi dhe se zbatimi i kësaj marrëveshjeje, përkatësisht statuti i asociacionit do të respektojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 26 dhjetor 2015.⁶⁵ Ministrija Tahiri, ndër të tjera, deklaroi se “asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do të jetë nivel i tretë i qeverisjes.”⁶⁶

Disa deputetë të këtij Komisioni kishin kërkuar një raportim më të gjerë nga Ministrija Tahiri rreth procesit të dialogut në Bruksel, mirëpo zonja Tahiri ishte përgjigjur se deputetët mund t'i drejtohen me pyetje me shkrim në adresën zyrtare të Ministrisë.

4.8 Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka qenë një nga Komisionet me më së shumti mbledhje të mbajtura gjatë legjislaturës së pestë, me gjithsej 96 takime, ku në 13 prej të cilave ka diskutuar për temat e dialogut Kosovë – Serbi, përfshirë këtu 2 takime ku kjo temë ka qenë pjesë e rendit të ditës (Shih Tabelën 10).

Duke u bazuar në fushëveprimtarinë e Komisionit, çështjet më të diskutuara nga anëtarët e këtij Komisioni lidhur me dialogun Kosovë – Serbi ishin energjetika, më konkretisht furnizimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe anëtarësimi i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) në Rrjetin Evropian të Transmetuesve të energjisë Elektrike (ENTSO-E); si dhe çështja e marrjes së kodit telefonik të Kosovës. Çështje tjera të diskutuara në Komision rreth dialogut me Serbinë ishin edhe aviacioni, strukturat paralele serbe dhe masat e reciprocitetit lidhur me tregtinë me Serbinë.

Marrëveshjen për Energjinë e nënshkruar mes Kosovës dhe Serbisë së Bruksel në vitin 2013, është trajtuar disa herë në këtë Komision, ku janë ftuar në raportim dy Ministra përkatësisht Ministri i Zhvillimit Ekonomik z. Blerand Stavileci (nëntor 2016) si dhe Ministrija për Dialog znj. Edita Tahiri (mars 2017).

Në bazë të interesimit të deputetëve, Ministri Stavileci dhe Ministrija Tahiri kanë raportuar mbi të drejtat dhe obligimet që dalin nga marrëveshja e Kosovës me Serbinë lidhur me energjinë elektrike, më specifiku lidhur me procesin e anëtarësimit të KOSTT në

TABELA 9: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR ADMINISTRATË PUBLIKE, QEVERISJE LOKALE DHE MEDIA

Mbledhja	Data	Rend dite/ Diskutim	Çështja e Diskutuar
1	10.10.2016	Rend dite	Asociacioni i Komunave Serbe. E ftuar: Edita Tahiri

⁶⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin nr. K0130/15, lidhur me vlerësimin e perputhshmerise se parimeve të “Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe ne Kosovë”: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_130_15_shq.pdf (qasur me 19.07.2017)

⁶⁶ Procesverbali i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, i mbajtur me 10 tetor 2016: http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2016_10_10_11_6646_al.pdf (qasur me 22.07.2017)



TABELA 10: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Mbledhja	Data	Rend dite/ Diskutim	Çështja e Diskutuar
1	16.01.2015	Diskutim	Statusi i Trepçës
2	27.01.2015	Diskutim	Telekomunikacioni
3	21.04.2015	Diskutim	Aviacioni
4	14.07.2015	Diskutim	Telekomunikacioni
5	28.09.2015	Diskutim	Reciprociteti tregtar
6	20.10.2015	Diskutim	Telekomunikacioni
7	03.11.2015	Diskutim	Reciprociteti tregtar
8	03.05.2016	Diskutim	Aviacioni
9	19.07.2016	Diskutim	Telekomunikacioni
10	25.10.2016	Diskutim	Certifikatat ADR. E ftuar: Hykmete Bajrami
11	01.11.2016	Diskutim	Telekomunikacioni; Energjetika. I ftuar: Blerand Stavileci
12	24.11.2016	Diskutim	Energjetika. I ftuar: Blerand Stavileci
13	07.02.2017	Rend dite	Energjetika
14	07.03.2017	Rend dite	Energjetika. E ftuar: Edita Tahiri
15	02.05.2017	Diskutim	Energjetika

ENTSO-E. Që të dy Ministrat në raportimet përkatëse konstatuan se Marrëveshja për Energjinë është pozitive për vendin, duke evidentur se mungon vullneti politik nga shteti Serb për ta zbatuar në tërësi këtë marrëveshje, dhe kjo është arsyeja kryesore përse KOSTT ende nuk është anëtarësuar në ENTSO-E. Përveç ministrave, rreth KOSTT dhe furnizimit e shpërndarjes së energjisë dhe humbjeve në rrjet në veri të vendit, në Komision ka raportuar edhe Enver Halimi, kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), në mbledhjen e ftuar nga Komisioni ku ishte bërë shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2015.

Çështje tjetër e rëndësishme e cila është diskutuar në këtë Komision dhe që lidhet direkt me procesin e dialogut është marrëveshja për telekomunikacionin e arritur me 8 shtator 2013. Lidhur me këtë temë, më 19 korrik 2016 në Komision ka raportuar z. Kreshnik Gashi, kryetar i Bordit i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), si dhe me 1 nëntor 2016 Ministri i zhvillimit ekonomik, z. Blerand Stavileci. Në të dyja rastet deputetët ishin të interesuar të dinin për procedurat e marrjes së kodit telefonik të vendit (+383), modalitetet e operimit të operatorit serb

në Kosovë, komform marrëveshjes së Brukselit, si dhe statusin e operatorëve ilegal serb në veri të vendit.

Edhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, znj. Hikmete Bajrami, ishte e ftuar për raportim në këtë Komision, ku ndër të tjera ajo kishte raportuar rreth marrëveshjen të arritur me Serbinë rreth njohjes së certifikatave të ADR-së si dhe vendosjen e masave reciproke në këtë drejtim. Ndonëse marrëveshja rreth njohjes së certifikatave të ADR-së ishte diskutuar në këtë takim, ky diskutim nuk ka qenë i paraparë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje, por vetëm është përmendur gjatë raportimit të Ministres Bajrami për punët e realizuara nga Ministria dhe objektivat për të ardhmen.

Tema tjera të ndërlidhura me dialogun e Brukselit e që u diskutuan në këtë Komision ishin edhe çështja e operimit të një aviokompanie serbe në territorin e Kosovës, diskutimi potencial i statusit të Trepçës në negociatat e Brukselit dhe reciprociteti tregtar me Serbinë.

4.9 Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale nga gjithsej 57 mbledhje të realizuara gjatë legjislaturës së pestë, ka diskutuar vetëm 4 herë lidhur me temat e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë (Shih Tabelën 11). Në dy nga këto katër takime është diskutuar rreth kthimit të fondit pensional nga Serbia si dhe rreth çështjes së pensioneve kontributdhënëse për shqiptarët nga Kosova që kanë punuar deri në vitin 1999.

Në të dyja rastet kur u diskutuan këto çështje i ftuar në Komision për raportim ishte Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z.Arban Abrashi, me 3 qershor 2015 dhe 16 nëntor 2016. Lidhur me kthimin e fondit pensional dhe pensioneve kontributdhënëse, Ministri Abrashi kishte deklaruar se shteti i Kosovës i posedon "të gjitha shënimet në administratë pensionale, sado që ka pasur dëmtime gjatë kohës së luftës, dhe se ekziston një databazë solide e të dhënave se sa ka qenë numri i gjithë pensionistëve kontributdhënës në vitet 80' dhe 90'".⁶⁷

Ndonëse ky Komision ka diskutuar për fondin pensional dhe çështjet e hapura me Serbinë në këtë drejtim, megjithatë nuk ka dal me ndonjë rekomandim apo qëndrim që do të ndërliedhe me dialogun me Serbinë apo ndonjë marrëveshje specifike.

Çështje tjetër e diskutuar në këtë Komision ishte edhe licensimi i barërave dhe kompanive që importojnë barëra. Në mbledhjen e datës 27 maj 2015, ku i ftuar në raportim ishte z. Arianit Jakupi, Ushtrues Detyre i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Produkte Mjekësore (AKPM), deputetët e Komisionit ngritën çështjen e licensimit të kompanive nga veriu i vendit dhe pyetën se a është duke u trajtuar kjo çështje në kuadër të dialogut me Serbinë.

Z. Jakupi, para anëtarëve të Komisionit, deklaroi se është duke u diskutuar në Bruksel lidhur me njohjen e certifikatave të produkteve medicinale, dhe se që nga fillimi i negociatave në Bruksel AKPM ka filluar licensimin e institucioneve që merren me tregtim të barërave në veri të vendit. Kryeshefi i AKPM poashtu deklaroi se licensimi do të bëhet konform legjislationit në fuqi në Kosovë, dhe se qytetarët e vendit do të kenë barna të licensuara dhe importi i tyre do jetë i rregulluar me ligj dhe i kontrolluar.⁶⁸

Pas nënshkrimit të marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe, deputetja Besa Baftiu në mbledhjen e mbajtur me datën 30 shtator 2015 kishte propozuar të futej si pikë e rendit të ditës edhe diskutimi rreth kësaj marrëveshjeje, për arsye se, sipas deputetes Baftiu, pika 4d. e kësaj marrëveshjeje ka të bëjë me sektorin e shëndetësisë, ku thuhet se asociacioni do të ushtrojë mbikëqyrje të plotë në shërbimin shëndetësor primar, sekondar dhe në përkujdesje sociale. Megjithatë, ky propozim nuk u aprovua nga deputetët e tjerë të Komisionit, dhe Komisioni vazhdoi takimin me rendin e ditës ashtu siç ishte përcaktuar më herët.

TABELA 11: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE MIRËQENJE SOCIALE

Mbledhja	Data	Rend dite/ Diskutim	Çështja e Diskutuar
1	27.05.2015	Diskutim	Certifikatat e produkteve medicinale
2	03.06.2015	Diskutim	Fondi Pensional. I ftuar: Arban Abrashi
3	30.09.2015	Diskutim	Asociacioni i Komunave Serbe
4	16.11.2016	Diskutim	Fondi Pensional. I ftuar: Arban Abrashi

⁶⁷ Procesverbali i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e mbajtur me 16 nëntor 2016: http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/proc_2016_11_16_13_6729_al_rCvsnsmEEM.pdf (qasur me 22 korrik 2017)

⁶⁸ Procesverbali i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e mbajtur me 27 maj 2015: http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/27.05_fvhaKYfmNE.pdf (qasur me 22.07.2017)

4.10 Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor përgjatë legjislaturës së pestë ka realizuar gjithsej 61 mbledhje. Në tre takime të Komisionit janë diskutuar çështje që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi, ndërsa nuk është trajtuar as asnjëherë si pikë e rendit të ditës të mbledhjeve të tij (Shih Tabelën 12).

Temë qendrore e diskutimeve të Komisionit ishte çështja e librave kadastral të Kosovës të cilat ndodhen në Serbi. Çështje e cila është trajtuar në kuadër të dialogut Kosovë – Serbi duke prodhuar edhe një marrëveshje.

Në dy nga tri takimet e këtij Komisioni ku u diskutua rreth çështjes së librave kadastral, në Komision ishte ftuar Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferid Agani për të raportuar rreth planeve dhe prioriteteve të ministrisë që drejtonte.⁶⁹

Në të gjitha rastet kur u diskutua për librat kadastral, u konstatua që moskthimi i këtyre të dhënave nga Serbia dhe mungesa e tyre në Kosovë paraqet problem, pasi që shumë projekte nuk mund të realizohen në mungesë të informacioneve adekuate. Nga diskutimet e anëtarëve të Komisionit rreth librave kadastral dhe moskthimit

të tyre nga Serbia, është vërejtur se as deputetët por as ministri Agani nuk i janë referuar asnjëherë marrëveshjes mes Kosovës dhe Serbisë rreth librave kadastral. Çështja e shënimeve kadastrale ishte diskutuar qysh në raundin e parë të dialogut Kosovë-Serbi, dhe ishte arritur në raundin e gjashtë të bisedimeve të mbajtur më 2 shtator 2011.⁷⁰ Me anë të kësaj marrëveshje palët ishin pajtuar që, të bëjnë çdo përpjekje për të vendosur një kadastër plotësisht të besueshëm në Kosovë me qëllim për të mbrojtur të drejtat e njerëzve me kërkesa legjitime në pronë.

Përveç librave kadastral, në këtë Komision më 2 shkurt 2015, deputeti Haxhi Shala kishte pyetur ministrin Agani se çka parasheh plani hapësinor i Kosovës për Asociacionin e Komunave me shumicë Serbe, mirëpo deputeti Shala nuk kishte marr përgjigje.

Poashtu, në mbledhjen e 14 marsit 2016, ku i ftuar në raportim ishte z. Agani, u përmend edhe çështja e kufirit administrativ mes Mitrovicës së Jugut dhe asaj të Veriut. Në këtë takim, ministri Agani deklaroi para deputetëve se "Ministria është e involvuar në procesin e nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet komunës së Mitrovicës së Veriut, Mitrovicës së Jugut, MAPL dhe MMPH-së kur janë në pyetje zbatimi i planit zhvillimor komunal, hartës zonale komunale dhe përcaktimit dhe përcaktimit të linjës administrative ndërmjet dy komunave që ka dalë edhe nga marrëveshja e Brukselit."⁷¹

TABELA 12: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR BUJQËSI, PYLLTARI, MJEDIS E PLANIFIKIM HAPËSINOR

Mbledhja	Data	Rend dite/ Diskutim	Çështja e Diskutuar
1	02.02.2015	Diskutim	Librat kadastral, Asociacioni; I ftuar: Ferid Agani
2	23.06.2015	Diskutim	Librat kadastral
3	14.03.2016	Diskutim	Librat kadastral: I ftuar: Ferid Agani

69 Në të dy rastet, Ministri Agani ishte ftuar në Komision për të raportuar për planet dhe prioritetet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin 2015, respektivisht 2016.

70 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Marrëveshjet e Dialogut Teknik, "Konkluzionet e Dakorduara për Shënimet Kadastrale" arritur më 2 shtator 2011 në Bruksel. I qasshëm në, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Konkluzionet_0210_shenime.pdf (qasur me 19.07.2017)

71 Procesverballi i mbledhjes së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, i mbajtur me 14 mars 2016: http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/proc_2016_03_14_11_6353_aL_uSEnMCYpeg.pdf (qasur me 22.07.2017)

4.11 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së gjatë legjislaturës së pestë ka realizuar gjithsej 48 mbledhje. Në përgjithësi, ky Komision nuk e ka pasur në krye të agjendës së vet çështjen e dialogut Kosovë - Serbi, megjithatë nuk e ka anashkaluar këtë proces për çështjet të cilat bien në kuadër të fushëveprimtarisë së Komisionit, komform Rregullores së Punës së Kuvendit (Shih Tabelën 13). Ky Komision në tërësi ka diskutuar 10 herë rreth këtij procesi, duke e përfshirë këtë çështje dy herë si pikë të rendit të ditës.

Diskutimet kryesore ky Komision i ka zhvilluar pas ndalesës dhe arrestimit në Serbi të zëvendës-komandantit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, më 29 shtator 2016.

Rreth kësaj çështjeje, Komisioni mbajti mbledhje me datën 5 tetor 2016 ku si pikë të vetme të rendit të ditës kishte diskutimin rreth arrestimit të z. Nehat Thaçit. Në këtë takim Komisioni i bëri thirrje

autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare që të ushtrijnë trysni mbi Beogradin zyrtar, për ta liruar nënkolonel Nehat Thaçin. Komisioni, në mënyrë unanime nxorri konkluzionet ku ndër të tjera theksoi se "rruga integruese, ndërshtetërore po dëmtohet seriozisht, me veprimet e tilla dhe Komisioni kërkon zbatimin e masave reciproke ndërmjet dy shteteve."⁷²

Arrestimi i z. Nehat Thaçit në Serbi ishte temë diskutimi edhe në dy takime të tjera pasuese të Komisionit, të mbajtura me datat 12 dhe 18 tetor 2016. Lidhur me këtë çështje, Komisioni ftoi në raportim z. Hilmi Mehmeti, kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës si dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni, nga të cilët u kërkuar më shumë detaje rreth ditëve të pushimit të z. Thaçi, udhëtimit të tij në Serbi dhe veprimeve të ndërmarra nga Policia e Kosovës që do të ndikonin në lirimin e z. Thaçi.

Komisioni për Punë të Brendshme trajtoi me urgjencë tentativën e shtetit serb për të dërguar trenin ilegal me mesazhe propaganduese për shtetin e Kosovës brenda territorit të vendit, me datën 14 janar 2017.

Komisioni për Punë të Brendshme në mbledhjen e datës 17 janar 2017 ftoi në raportim Ministrin e Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni për të diskutuar rreth këtij incidenti dhe situatës së përgjithshme të sigurisë në vend. Në këtë mbledhje, ndër të tjera, Ministri

TABELA 13: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE MBIKËQYRJE TË FSK-SË

Mbledhja	Data	Rend dite/Diskutim	Çështja e Diskutuar
1	05.05.2015	Diskutim	Përfaqësimi rajonal
2	08.08.2016	Diskutim	Liria e lëvizjes; zbatimi i marrëveshjeve
3	05.10.2016	Rend dite	Arrestimi i Nehat Thaçit
4	12.10.2016	Diskutim	Arrestimi i Nehat Thaçit
5	18.10.2016	Diskutim	Arrestimi i Nehat Thaçit
6	29.11.2016	Diskutim	Mungesa e buxhetit për implementim të marrëveshjeve
7	07.12.2016	Diskutim	Transformimi i FSK-së në Ushtri
8	17.01.2017	Rend dite	Raportim mbi trenin dhe murin ilegal. I ftuar: Skender Hyseni
9	08.02.2017	Diskutim	Shuarja e strukturave paralele; Transformimi i FSK-së në Ushtri
10	13.02.2017	Diskutim	Shuarja e strukturave paralele

72 Procesverbali i mbledhjes së Komisionit i datës 05.10.2016: http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/proc_2016_10_05_11_6644_al_UeKUVL8Jyb.pdf (qasur me 18.07.2017)

Hyseni u pyet për aksionin e policisë në parandalimin e hyrjes së trenit ilegal në Republikën e Kosovës si dhe gjendjen e sigurisë në vend, me theks të veçantë në pjesën veriore të vendit.⁷³ Çështja e sigurisë në veri të vendit, me theks të veçantë në shuarjen e strukturave paralele dhe garantimin e lëvizjes së lirë në këtë pjesë ishin tema që u diskutuan edhe në mbledhje tjera të këtij Komisioni.

Transformimi i FSK-së në ushtri dhe pengesat e shfaqura në këtë proces poashtu kanë qenë temë diskutimi në këtë Komision duke e ndërlidhur këtë çështje edhe me dialogun, sikurse dhe përfaqësimi i Republikës së Kosovës në organizata e tryeza rajonale, mungesa e buxhetit në përgjithësi dhe ndikimi në mos-zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit.

Disa nga deputetët e këtij Komisioni, më konkretisht nënkryetarja e Komisionit Ganimete Musliu dhe anëtarët Nuredin Ibishi e Zafir Berisha, me 27 mars 2017 realizuan një vizitë pune në Stacionin Policor në Zubin Potok, ku u prit nga Komandanti i Stacionit, Toger Zvezdan Milojeviq. Kjo ishte një nga vizitat e para të këtij lloji në vend, pasi që deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk kishin realizuar vizita të tilla me vetë-iniciativë. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja nga afër me kushtet e punës, sfidat në punët e përditshme në ushtrimin e detyrave policore, si dhe për zbatimin e Ligjit për Policinë e Kosovës.

4.12 Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Intelgjencë

Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së ka realizuar gjithsej 28 takime gjatë legjislaturës së pestë. Takimet e këtij Komisioni janë mbajtur me dyer të mbyllura për shkak të sensitivitetit të informacioneve që trajtohen nga ky Komision. Ky Komision nuk ka publikuar as procesverbalet e as transkriptat e takimeve dhe rrjedhimisht ka qenë e pamundur për hulumtuesit e KDI-së që të sigurojnë informacione relevante lidhur me trajtimin e temave të dialogut me Serbinë nga ky Komision. Për më tepër, ky Komision nuk ka pasur asnjëherë në rend të ditës ndonjë çështje e cila ndërlidhet me procesin e dialogut.

Vlen të përmendet se në kohën e arrestimit të nënkolonelit të policisë për rajonin e Mitrovicës z. Nehat Thaçit në Serbi, ky Komision nuk ka mbajtur mbledhje të menjëhershme, sikurse shumica e Komisioneve tjera në Kuvend. Takimi i parë i këtij Komisioni pas arrestimit të z. Nehat Thaçi u zhvillua me datën 17 tetor 2016, ku si pikë e rendit të ditës mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.

4.13 Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Gjatë legjislaturës së pestë, Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka mbajtur gjithsej 47 takime. Nga të gjitha takimet e realizuara, ky Komision nuk ka trajtuar asnjëherë çështje apo tema të ndërlidhura me procesin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Përkundër faktit se Republika e Kosovës dhe Serbia kanë arritur një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve implementimi i së cilave paraqet edhe implikime buxhetore për vendit, megjithatë ky Komision nuk ka konsideruar të nevojshme debatin rreth këtyre marrëveshjeve apo mënyrës se si është duke u shpenzuar buxheti i vendit për implementimin e tyre.

4.14 Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione përgjatë legjislaturës së pestë realizoi gjithsej 48 takime. Ky Komision ka diskutuar rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi në 6 takime të tij duke e përfshirë 2 herë si pikë të rendit të ditës (Shih Tabelën 14).

Çështje kryesore e trajtuar nga Komisioni, përkatësisht në 4 prej 6 takimeve, ishte çështja e personave të pagjetur nga koha e luftës në Kosovë dhe trajtimi potencial i kësaj çështje në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi.

Në mbledhjen e mbajtur më 20 janar 2015, Komisioni u dakordua të mirrej më intensivisht me çështjen e të pagjeturve, ku në mbledhjen pasardhëse më 25 mars 2015, si pikë të vetme të rendit të ditës ishte raportimi i z. Prenk Gjetaj - Kryetar i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe z. Nehat Fetoshi - përfaqësues i peticionit për zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit.

Në këtë takim, deputetët e Komisionit por edhe të ftuarit në këtë mbledhje u dakorduan se nuk është duke u bërë sa duhet në zbardhjen e fatit të z.Ukshin Hoti, sikurse edhe në trajtimin e çështjes së të pagjeturve. Nga ky takim, të pranishmit u dakorduan se tema e të pagjeturve duhet të trajtohet edhe në bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Për më tepër, në këtë takim u diskutua edhe ideja e kushtëzimit

⁷³ Procesverbal i mbledhjes së Komisionit i datës 17.01.2017: http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/proc_2017_01_17_11_6801_aL_upET6uV2YD.pdf (qasur me 18.07.2017)

TABELA 14: DISKUTIMET RRETH DIALOGUT NË KOMISIONIN PËR TË DREJTA TË NJERIUT, BARAZI GJINORE, PERSONA TË PAGJETUR DHE PETICIONE

Mbledhja	Data	Rend dite/Diskutim	Çështja e Diskutuar
1	20.01.2015	Diskutim	Personat e zhdukur
2	25.03.2015	Rend dite	Personat e zhdukur
3	07.04.2015	Rend dite	Personat e zhdukur
4	29.04.2015	Diskutim	Personat e zhdukur
5	03.03.2016	Diskutim	Fondi pensional
6	30.09.2016	Diskutim	Arrestimi i Nehat Thaçit

të bisedimeve me Serbinë pikërisht me përfshirjen e çështjes së të pagjeturve në dialog.⁷⁴

Në takimin vijues të Komisionit, i mbajtur me datën 7 prill 2015, Komisioni shqyrtoi Raportin e grupit punues mbi peticionin për zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit,⁷⁵ pas së cilës u dakordua që të përfshinte një rekomandim për Qeverinë e Republikës së Kosovës që tema e të pagjeturve të përfshihet në agjendën e dialogut me Serbinë. Komisioni gjithashtu miratoi edhe një rekomandim për Qeverinë e vendit, nga e cila kërkoi të raportoj para Kuvendit në baza 6-mujore sa i përket trajtimit të çështjes së të pagjeturve.⁷⁶

Edhe Komisioni për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, reagoi ndaj arrestimit të nënkolonelit të policisë për rajonin e Mitrovicës z. Nehat Thaçit në Serbi. Në mbledhjen e mbajtur më datë 30 shtator 2016, ky Komision miratoi një reagim të përbashkët me anë të së cilit vinin në pah qasjen konstruktive të Republikës së Kosovës si në procesin e dialogut, ashtu edhe në ndërtimin e fqinjësisë së mirë dhe avancimin e bashkëpunimit rajonal. Duke kritikuar qasjen e shtetit serb dhe duke i bërë thirrje "mekanizmave ndërkombëtare që të bëjnë presion mbi shtetin serb, në mënyrë që z. Nehat Thaçi të lirohet menjëherë dhe pa asnjë kusht."⁷⁷

Ky Komision tërthorazi ka shtjelluar edhe çështjen e fondit pensional, në takimin e datës 3 mars 2016, ku i ftuar në raportim në Komision ishte Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari. Gjatë bashkëbisedimit me Avokatin e Popullit, u potencua se çështja e fondit pensional nuk do të duhej të trajtohej në bisedimet e Brukselit me Serbinë.⁷⁸

4.15 Komisioni Parlamentar për Stabilizim Asociim

Komisioni Parlamentar për Stabilizim-Asociim është Komisioni i përbashkët i Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian⁷⁹. Ky Komision është funksionalizuar pas ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes Kosovës dhe BE-së, dhe zhvillon seanca të përbashkëta mes deputetëve të Kosovës dhe eurodeputetëve të BE-së.⁸⁰

Deri më tani, Komisioni për Stabilizim-Asociim ka mbajtur dy takime: të parin me datën 16-17 maj 2016 në Kosovë, dhe të dytin me 23-24 nëntor 2016 në Strasburg të Francës. Në të dy këto takime të përbashkëta të deputetëve nga Kosova dhe BE-ja është diskutuar tema e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo

74 Procesverbal i takimit të Komisionit të mbajtur me datën 25 mars 2015: http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/proc_2015_03_25_10_5850_al_JasPssL498.pdf (qasur me 21.07.2017)

75 Me 31 mars të vitit 2014, në Kuvendin e Kosovës ishte dorëzuar një peticion me 11 mijë nënshkrime nga qytetarët e Rahovecit ku kërkohet zbardhja e fatit të Ukshin Hotit/Rahovecianët kishin kërkuar nga institucionet e Kosovës të merren masa të shpejta dhe të ketë angazhim më të madh që të zbardhet fati i Hotit. Grupi punues që kishte shqyrtuar këtë peticion ishte formuar gjatë legjislaturës së katërt, menjëherë pas pranimit të peticionit të dorëzuar në Kuvend.

76 Procesverbal i takimit të Komisionit të mbajtur me datën 7 prill 2015: http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/proc_2015_04_07_15_5871_al_ëmCjNxq9sa.pdf (qasur me 21.07.2017)

77 Procesverbal i takimit të Komisionit të mbajtur me datën 30 shtator 2016: [http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/proc_2016_09_30_13_6633_al\(1\)_g48e55a5Uz.pdf](http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/proc_2016_09_30_13_6633_al(1)_g48e55a5Uz.pdf) (qasur me 21.07.2017)

78 Procesverbal i takimit të Komisionit të mbajtur me datën 03 mars 2016: http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/Komisionipertedrejtatenjeriut_48c2hpRTxH.pdf (qasur me 21.07.2017)

79 Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, neni 132: http://www.mei-ks.net/repository/docs/kosovo-eu_saa_final_sq.pdf (qasur me 22.07.2017)

80 Sipas nenit 132 të MSA-së, që shërben edhe si bazë ligjore për themelimin e këtij Komisioni, Komisioni mbanë së paku një mbledhje në vit dhe kryesohet me rotacion nga një anëtarë i Parlamentit Evropian dhe nga një anëtarë i Parlamentit të Kosovës, sipas dispozitave që do të parashikohen nga rregullojta e punës së këtij Komisioni.

konfirmohet edhe nga deklaratat dhe rekomandimet përfundimtare të Komisionit të cilat kanë përfshirë çështje rreth dialogut të ndërmjetësuar nga BE.

Në takimin e parë, Komisioni vuri në dukje progresin e bërë në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënies ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe bëri thirrje për angazhim konstruktiv në formulimin dhe implementimin e marrëveshjeve të ardhshme; shprehu shqetësimin lidhur me numrin e lartë të personave të zhdukur dhe progresin e ulët të bërë në këtë drejtim, si dhe për mungesën e një vullneti politik në Serbi, si dhe në anën e Kosovës kur është fjala për implementimin e ligjit për viktimat e dhunës seksuale të luftës, që të merren me krimet e kryera gjatë luftërave në ish Jugosllavi, si dhe shprehu shqetësimin në lidhje me numrin e vogël të gjykimeve dhe dënimeve për këto krime; bëri thirrje për shuarjen e strukturave serbe brenda territorit të Kosovës, pasi që ekzistenca e tyre është barrierë (pengesë) për integrimin e serbeve të Kosovës në jetën politike, institucionale, ekonomike dhe sociale të Republikës së Kosovës.

Në mbledhjen e dytë të Komisionit që u mbajt në Strasburg, Komisioni përshëndeti marrëveshjen e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për telekomunikacionin, sipas së cilës Unioni i Telekomunikacionit Ndërkombëtar do t'ia ndajë Kosovës kodin telefonik 383, si dhe i bëri thirrje të dyja palëve që t'i normalizojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre, që t'i zbatojnë plotësisht të gjitha marrëveshjet e lidhura, duke theksuar se progresi matet me shkallën e zbatimit në terren të marrëveshjeve të arritura gjatë dialogut, kujtoi se normalizimi i plotë i marrëdhënies ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është kusht i rëndësishëm për përparimin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian për të dyja vendet.

Gjatë këtij takimi, Komisioni diskutoi edhe për situatën në veri të vendit, duke përshëndetur asokohe nisjen e ndërtimit në Urën e Mitrovicës dhe planin e Qeverisë për hapjen e zyrave të regjistrimit civil në veri, dhe duke shprehur shqetësimin për funksionimin e strukturave paralele në atë pjesë. Në fund, Komisioni inkurajoi Qeverinë e Kosovës dhe përfaqësuesit e Serbisë të Kosovës që t'i intensifikojnë negociatat me qëllim të integritet të komuniteteve në formën e përfaqësimit të pavarur prej nismave të grupeve dhe partive politike Jo-Kosovare, si dhe u bëri thirrje të gjithë akterëve politik që të përmbahen nga deklaratat nxitëse të cilat mund ta dëmtojnë dialogun politik mes dy vendeve.⁸¹

Pjesë e rëndësishme e punës së Komisionit për Stabilizim-Asociim janë edhe takimet përgatitore, të cilat Kuvendi i Kosovës dhe Parlamenti Evropian i realizojnë ndaras. Anëtarët e Komisionit për Sta-

bilizim-Asociim nga Kuvendi i Kosovës gjatë legjislaturës së pestë kanë realizuar gjithësej 14 takime, prej të cilave në dy raste është diskutuar për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Më konkretisht, në takimin e datën 16 maj 2016, i ftuar në Komision ishte Ministri i Punëve të Jashtme, z.Enver Hoxhaj, ku u diskutua për bashkëpunimin rajonal dhe fqinjësinë e mirë, përfshirë këtu edhe dialogun me Serbinë. Kurse, në takimin përgatitor të mbajtur me datën 11 prill 2017, e ftuar në raportim në këtë Komision ishte Ministria e Dialogut, znj. Edita Tahiri. KDI nuk ka arritur ti siguroj transkriptet dhe procesverbalet e këtyre dy takimeve pasi që takimet përgatitore të Komisionit për Stabilizim-Asociim mbahen me dyer të mbyllura dhe prezenca e monitoruesve dhe mediave është e ndaluar.

4.16 Takimi Koordinues i Komisioneve Parlamentare Rreth Dialogut Kosove-Serbi

Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme me përkrahjen e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) mbajti takimin e parë koordinues të Komisioneve Parlamentare të Kuvendit rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi. Ky takim u organizua në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar në mes Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe Kuvendit të Kosovës më 6 korrik 2016⁸² lidhur me fuqizimin e mbikqyrjes së Kuvendit ndaj Qeverisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi.

Takimi koordinues i komisioneve parlamentare u organizua me synimin për të ofruar një platformë diskutimi, bashkëndimi dhe dakordësimi në mes Komisioneve Parlamentare rreth rolit të tyre në procesin e dialogut Kosovë – Serbi. Gjithashtu u synua ndërtimi i bashkëpunimit të ndërsjellë për monitorimin, mbikqyrjen, pjesëmarrjen dhe transparencën e këtij procesi. Kjo nismë u ndërmorr duke u bazuar në Rezolutën Nr. 04-R-001⁸³ si dhe në Rezolutën Nr. 04-R-08⁸⁴ të cilat përcaktojnë rolin mbikqyrës dhe pjesëmarrës të Kuvendit dhe Komisioneve përkatëse në procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

Temat kryesore që u diskutuan gjatë këtij takimi ishin roli i komisioneve Parlamentare në procesin e dialogut Kosovë-Serbi; koordinimit i ndërsjellë, mbikqyrjes së procesit të dialogut sipas fushëveprimit të komisioneve parlamentare të Kuvendit si dhe monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve të arritura në kuadër të këtij procesi; konsultimi i komisioneve parlamentare në lidhje me çështjet që duhet të dis-

81 Deklaratat dhe rekomandimet nga dy takimet e Komisionit për Stabilizim-Asociim mund të shkarkohen këtu: <http://kuvendikosoves.org/?cid=1,110,135> (qasur me 22.07.2017)

82 Memorandumi i bashkëpunimit mes Kuvendit të Kosovës dhe KDI-së: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/MEMORANDUM_MIREKUPTIMI_NE_MES_KDI_DHE_KUVENDIT_TE_KOSOVES.pdf (qasur me 12.07.2017)

83 Rezoluta 04-R-01 për dialogun mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_dialogun_midis_R.Kosoves_dhe_R.Serbise_2.pdf (qasur me 12.07.2017)

84 Rezoluta 04-R-08 për normalizimin e marrëdhënies në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf (qasur me 12.07.2017)

kutohen në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi si dhe konsultimet me komisionet përkatëse gjatë procesit të negociimit të marrëveshjeve nga ana e Qeverisë; raportimi i rregullt dhe i vazhdueshëm nga ana e Qeverisë rreth zbatimit të marrëveshjeve përfshirë raportet të cilat dërgohen në Bruksel nga ana e Qeverisë; nevoja për kërkimin e ekspertizës për procesin e dialogut si dhe marrëveshjet e arritura në kuadër të tij dhe nevoja për informimin e qytetarëve rreth dialogut me Serbinë dhe konsultimin e tyre rreth rritjes së transparencës dhe temave që duhet të diskutohen në këtë proces.

Në takimin e parë koordinues në mes komisioneve parlamentare rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi, të organizuar nga Komisioni për Punë të Jashtme në bashkëpunim me KDI-në, kanë qenë të ftuar kryesuesit e të gjitha Komisioneve Parlamentare, ndërsa në takim morrën pjesë përfaqësues të 10 nga gjithësej 15 komisione parlamentare.⁸⁵

Në këtë takim, pjesëmarrësit paraqitën qëndrimet e tyre dhe rekomandimet për rritjen e pjesëmarrjes dhe monitorimit të Kuvendit ndaj procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Propozimet e tyre varionin nga çështja për të cilën diskutohej, por në përgjithësi, disa nga konkluzionet kryesore që u nxorrën nga ky takim ishin se Dialogu Kosovë-Serbi është një çështje e interesit shtetëror, duhet të jetë një çështje mbi partiake dhe të ndërtohet një konsensus i gjerë politik dhe shoqëror dhe se ky dialog është i pa alternativë dhe garanton rrugëtimin tonë drejtë BE-së.

Deputetët pjesëmarrës në këtë takim vlerësuan se procesi i dialogut duhet të riformohet dhe të ristrukturohet, të jetë më transparent, të ketë informim më të mirë për qytetarët dhe duhet të adresohen kërkesat e qytetarëve rreth temave që duhet të diskutohen në dialog.

Sa i përket pjesëmarrjes së Kuvendit në dialog, deputetët u pajtuan se Kuvendi dhe Komisionet e Kuvendit duhet të kenë rol aktiv në procesin e dialogut Kosovë-Serbi sa i përket qasjes së Kosovës në këtë dialog përfshirë edhe ofrimin e kontributin direkt gjatë procesit të negociimit të marrëveshjeve. Marrëveshjet që do të nënshkruhen në Bruksel mes Kosovës dhe Serbisë t'i prezantohen paraprakisht Kuvendit për diskutim dhe jo pas nënshkrimit të tyre. Poashtu, deputetët u dakorduan se monitorimi i qeverisë duhet të jetë më sistematik dhe gjithëpërfshirës dhe se numri i raportimeve në Kuvend duhet të rritet përmes Komisioneve parlamentare, të cilat duhet të kërkojnë informacione të detajuara nga qeveria e Kosovës rreth procesit të dialogut, marrëveshjeve dhe zbatimit të tyre me anë të raportimeve të rregullta dhe të vazhdueshme.



Dialogu Kosovë-Serbi është një çështje e interesit shtetëror, duhet të jetë një çështje mbi partiake dhe të ndërtohet një konsensus i gjerë politik dhe shoqëror dhe se ky dialog është i pa alternativë dhe garanton rrugëtimin tonë drejtë BE-së.

⁸⁵ Pjesëmarrës në këtë takim të përbashkët të komisioneve ishin z. Elmi Reçica, Kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme, z. Muhamet Mustafa – Kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, znj. Njomza Emini – Kryetare e Komisionit për Integritet Evropian, znj. Albulena Haxhiu – Kryetar i Komisionit për Legjislacion, znj. Flora Brovina – Kryetare e Komisionit për Shëndetësi, znj. Xhevahire Izmaku – Kryetare e Komisionit për Administratë Publike, qeverisje lokale dhe media, z. Haxhi Shala – Kryetar i Komisionit për Mbrojtje dhe Mbrojtje të Mbrojtjes, znj. Lirije Kajtazi – Kryetare e Komisionit për Drejtat e Njeriut, znj. Safete Hadërgonaj, Nënkrjetare e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe z. Nuredin Ibishi – Anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme.

REKOMANDIME

Deputetët e Kuvendit dhe komisionet parlamentare gjatë legjislaturës së VI-të e cila është konstituuar në shtator 2017 kanë diskutuar rreth dialogut Kosovë-Serbi dhe të ardhmes së këtij procesi duke theksuar nevojën e fuqizimit të rolit të Kuvendit në këtë proces, veçanërisht partitë opozitare të cilat kanë kundërshtuar edhe udhëheqjen e këtij procesi nga ana e Presidentit të vendit. Por në këtë legjislaturë nuk është mbajtur asnjë seancë me pikë të veçantë të rendit të ditës rreth çështjeve që ndërliken me dialogun

Kosovë-Serbi dhe asnjë anëtar i Qeverisë nuk është thirrur në interpellancë për këtë proces.

Duke konsideruar se dialogu Kosovë-Serbi është duke u futur në fazën përmbyllëse të tij në kuadër të së cilës pritet nënshkrimi i një marrëveshjeje ligjërish të obligueshme në mes Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, KDI ofron rekomandimet e mëposhtme rreth rolit të Kuvendit në këtë proces.

- Kuvendi i Kosovës duhet të jetë epiqendra e diskutimit të fazës së re të dialogut Kosovë-Serbi me synim garantimin e bashkërendimit institucional sipas praktikave ndërkombëtare të bashkëpunimit në mes institucioneve në çështjet e interesit nacional dhe ato të politikës së jashtme.
- Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerr një Rezolutë të re me anë të së cilës i jepet legjitimitet këtij procesi. Me anë të kësaj Rezolute Kuvendi i Kosovës duhet të përcaktoj: i) formatin e dialogut, ii) përbërjen e ekipit negociues, iii) vijat e kuqe të shtetit të Kosovës, iv) platformën shtetërore të Kosovës të prezantuar nga ana e qeverisë, v) epilogun e këtij procesi - njohja e ndërsjelltë, anëtarësimi i Kosovës në OKB, vi) temat të cilat duhet të diskutohen si çështja e të pagjeturve, dëmshtëpërlimet e luftës, reparacionet, suksesioni, kthimi i artifakteve, vii) format e raportimit të ekipit negociues dhe konsultimin e vazhdueshëm të Kuvendit gjatë negociimit të marrëveshjeve.
- Marrëveshjet e dialogut Kosovë - Serbi të cilat janë duke u negociuar nga ekipi negociator i Kosovës duhet të diskutohen në Kuvendin e Kosovës me anë të raportimeve të rregullta dhe konsultimeve të vazhdueshme, ndërsa komisionet parlamentare duhet të përfshihen në temat të cilat bien në fushëveprimin e tyre.
- Deputetët e Kuvendit duhet të përdorin mekanizmat e mbikqyrjes parlamentare përfshirë pyetjet parlamentare, diskutimet në seanca, interpellancat ndaj përfaqësuesve të qeverisë dhe ekipit negociues për më shumë llogaridhënie, transparencë dhe bashkërendim lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi dhe marrëveshjeve të këtij procesi.
- Komisionet parlamentare duhet të përfshijnë në planet e punës së tyre mbikqyrjen e ekzekutivit dhe institucioneve zbatuese të marrëveshjeve me anë të raportimeve të rregullta.
- Komisionet parlamentare duhet të vazhdojnë koordinimin në mes tyre me synim ndërtimin e një platforme të bashkëpunimit të ndërsjelltë për monitorimin, mbikqyrjen, pjesëmarrjen dhe transparencën e procesit të dialogut Kosovë-Serbi dhe rolit të komisioneve në këtë proces.
- Deputetët e Kuvendit dhe komisionet parlamentare duhet të organizojnë vizita në terren dhe në institucionet përgjegjëse për të monitoruar nga afër zbatimin e marrëveshjeve, ngecjet në proces dhe masat që duhet të ndërmerren për adresimin e tyre.
- Deputetët e Kuvendit dhe Komisionet parlamentare duhet të organizojnë takime të rregullta me qytetarët për ti informuar ata rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi dhe për të artikuluar kërkesat e tyre në seancat e Kuvendit.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA